

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P.nr. 526/05

Data: 2 Tetor 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga:

- 1) Gjykatësi i EULEX-it Z. Francesco Florit, kryetar i trupit gjykues,
- 2) Gjykatësi i EULEX-it Z. Tron Gundersen, anëtar i trupit gjykues,
- 3) Gjykatësi vendor, Z. Rrahman Retkoceri, anëtar i trupit gjykues,

Të ndihmuar nga nëpunësi i nënshkruar i gjykatës, në çështjen penale kundër:

Latif GASHI, gjithashtu i njohur si Komandant "Lata", Shqiptar i Kosovës, emri i babait Riza, emri i nënës Raba, i lindur më 12 Shtator 1961 në Doberdol, komuna e Podujevës, ka diplomuar në fakultetin juridik në Prishtinë dhe aktualisht punon si këshilltar ligjor në Ministrinë e Mjedisit, më parë i padënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet asnjë procedurë tjetër penale; aktualisht është në paraburgim;

Nazif MEHMETI, gjithashtu i njohur si "Dini", Shqiptar i Kosovës, emri i babait Haradin, emri i nënës Shabe, i lindur më 20 Shtator 1961 në Shajkofc, komuna e Podujevës, i martuar, baba i tre fëmijëve. Ka diplomuar në fakultetin juridik në Prishtinë dhe aktualisht punon si Kryeshef Ekzekutiv i Kontrollit të Kredive në PTK, më parë i padënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet asnjë procedurë tjetër penale, aktualisht banon në [REDAKTUAR];

Rrustem MUSTAFA gjithashtu i njohur si "Remi", Shqiptar i Kosovës, emri i babait Musli, emri i nënës Nefise, i lindur më 27 Shkurt 1971 në Perpellac, ka diplomuar në fakultetin juridik në Prishtinë, Deputet në Parlamentin e Kosovës, më parë i padënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet asnjë procedurë tjetër penale, aktualisht banon në Prishtinë, [REDAKTUAR] nuk është në paraburgim;

Pas shqyrtimit gjyqësor në prani të Prokurorit Publik, të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës;

pas shqyrtimit të trupit gjykues të mbajtur më 1 Tetor 2009, në bazë të Neneve 349 dhe 351 të Ligjit të Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;

shpall këtë

DISPOZITIV:

i akuzuari **Latif Gashi** shpallet fajtor për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile siç është përshkruar në pikën 5, pikën 8 dhe pikën 14 të aktakuzës së ndryshuar të 30 Qershorit 2003 dhe siç përshkruhet në vijim;

të akuzuarit **Nazif Mehmeti** dhe **Rrustem Mustafa** shpallen fajtorë për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile siç është përshkruar në pikën 5 dhe pikën 8 të aktakuzës së ndryshuar të 30 Qershorit 2003 dhe siç përshkruhet në vijim;

Pika 5 e Aktakuzës Nga Tetori 1998 deri në fund të Prillit 1999, **Latif GASHI**, **Nazif MEHMETI** dhe **Rrustem MUSTAFA**, në bazë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në themelimin dhe vazhdimin e trajtimit çnjerëzor të civilëve Shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në qendrën e paraburgimit që ndodhej në Llapashticë, duke i mbajtur këta civilë të paraburgosur në kushte çnjerëzore, duke i privuar nga kushtet adekuate higjienike, ushqimi dhe uji, dhe trajtimi i nevojshëm mjekësor. Trajtimi çnjerëzor i civilëve të paraburgosur ka shkaktuar vuajtje të pamasë apo ishte shkelje e integritetit trupor dhe shëndetit të atyre personave të paraburgosur dhe përbënte zbatim të masave të frikësimit dhe terrorit. Si rrjedhim mbajnë përgjegjësi personale dhe më të lartë për krime lufte sipas Nenit 142 të KPJ lexuar me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ.

Pika 8 e Aktakuzës **Latif GASHI**, **Nazif MEHMETI** dhe **Rrustem MUSTAFA**, nga Tetori 1998 deri në fund të Prillit 1999, në bazë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve Shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Llapashticë në përpiqje që me dhunë ti detyrojnë ata që të pranojnë aktet e tradhtisë ndaj UÇK-së. Si rrjedhim mbajnë përgjegjësi personale dhe më të lartë për krime lufte të trajtimit çnjerëzor, vuajtjes shumë të madhe apo shkeljes së integritetit trupor apo të shëndetit, zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit dhe torturës sipas Nenit 142 të KPJ lexuar me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ.

Pika 14 e Aktakuzës Nga 2 Gushti 1998 deri në fund të Shtatorit 1998 **Latif GASHI**, ka urdhëruar dhe ka marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e [REDAKTUAR], një rojtar pylli Serb i cili ka qenë i paraburgosur në qendrat e paraburgimit që ndodheshin në Bare, Bajgorë në tentim që ta detyrojë të pranojë se ka kryer akte kundër UÇK-së ose që të jep informata të inteligjencë, dhe si rrjedhim mbanë përgjegjësi personale për krime lufte të trajtimit çnjerëzor, vuajtjes së pamasë dhe shkeljes së integritetit trupor ose të shëndetit, zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit dhe torturës sipas Nenit 142 të KPJ lexuar me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ.

Trupi gjykues,

duke konstatuar që më 30 Shtator 2009 prokurori publik ka tërhequr akuzën kundër Latif Gashit dhe Rrustem Mustafës nga pika 9 e aktakuzës së ndryshuar, pas leximit të nenit 349 p.3 të Ligjit të Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë,

REFUZON

akuzën nga pika 9.

Sa i përket të akuzuarit Naim Kadriu, trupi gjykues zyrtarisht konstaton se ai ka vdekur dhe si pasojë, sipas nenit 143 LPP

PEZULLON

procedurën penale ndaj të akuzuarit të lartpërmendur.

- - -

Për arsyet e lartpërmendura trupi gjykues, sipas Nenit 42 dhe 48 Paragrafi (1) dhe (2) Nënparagrafi 1 të LPP shpall këtë:

DËNIM

1. Latif Gashi do të vuaj dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 vitesh;
2. Nazif Mehmeti do të vuaj dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 vitesh;
3. Rrustem Mustafa do të vuaj dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 vitesh;

Koha të cilën të akuzuarit e kanë kaluar në paraburgim duhet të llogaritet si pjesë e dënimit me burgim sipas Nenit 50 KPRSFJ dhe Nenit 351 Paragrafi (1) Nënparagrafi (6) i LPP.

Të akuzuarit do të kompensojnë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 98 Paragrafi 1 dhe 2 të LPP, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Gjykata do të lëshojë një vendim të veçantë mbi shumën e shpenzimeve kur të sigurohen të dhënat e tilla, në pajtim me Nenin 96 të LPP.

Sipas Nenit 353 paragrafi 1 dhe 7 të LPP, paraburgimi i të akuzuarit Latif Gashi urdhërohet me një vendim të veçantë dhe do të zgjasë derisa aktgjykimi të marr formë të prerë ose derisa ai të vuaj dënimin.

KËRKESË PASURORE JURIDIKE

Sipas Nenit 351 paragrafi 1 n.7) të LPP, i akuzuari Latif Gashi do të kompensojë palën e dëmtuar [REDAKTUAR] për dëmet e shkaktuara, të cilat gjykata i përcakton në shumë prej 5.000 Euro.

ARSYETIMI

Historia procedurale

Më 19 Nëntor 2002 në Gjykatë është ngritur aktakuza kundër të tre të akuzuarve dhe kundër Z. Naim Kadriu.

Aktakuza më pas është ndryshuar më 4 Shkurt dhe 30 Qershor 2003. Sipas aktakuzës së ndryshuar, të akuzuarit janë gjykuar për 14 pika të ndryshme të aktakuzës, me të cilat janë akuzuar për kryerjen e veprës penale Krime Luftë kundër Popullatës Civile, në shkelje të nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (këtej e tutje KPRSFJ) – ligji i aplikueshëm në procedurës sipas Rregullores 1999/24 të lëshuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (këtej e tutje UNMIK) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK 2000/59.

Shqyrtimi gjyqësor në shkallën e parë është mbajtur përpara Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e cila, me vendimin e saj të 16 Korrikut 2003, ka hedhur poshtë pikat 4, 6, 7, 10 dhe 13, si dhe akuzat nga pikat 1 dhe 11 të aktakuzës; akuzat kundër të akuzuarve për trajtim çnjerëzor, rrahje dhe torturime të civilëve që pretendohet të jenë kryer në qendrat e paraburgimit në Majac the Potok nga pikat 5 dhe 8 gjithashtu janë hedhur poshtë, dhe akuza nga pika 12 kundër Nazif Mehmetit dhe akuza nga pika 14 kundër Nazif Mehmetit dhe Rustem Mustafës gjithashtu janë hedhur poshtë.

Me vendimin e lartpërmendur, të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprën penale Krime Luftë kundër Popullatës Civile, sa i përket akuzave të mbetura; si pasojë, Latif Gashi është dënuar me 10 vjet burgim, Nazif Mehmeti me 13 vjet burgim dhe Rustem Mustafa me 17 vjet burgim.

Avokatët mbrojtës të tre të akuzuarve kanë paraqitur ankesë kundër dënimit, duke kundërshtuar të gjitha pikat e aktakuzës për të cilat klientët e tyre janë shpallur fajtorë; Prokurori ka paraqitur ankesë vetëm sa i përket kohëzgjatjes së dënimit të cilin trupi gjyqësor e ka shpallur kundër Latif Gashit.

Gjykata Supreme, me vendimin e saj të datës 21 Korrik 2005, më tej e ka zvogëluar shtrirjen e aktakuzës “duke anuluar në tërësi” akuzat: 1, 2, 3 dhe 12 (të gjitha në lidhje me paraburgimin e paligjshëm dhe arrestimin), dhe duke i liruar të akuzuarit nga pika 11 e aktakuzës sepse pretendimi faktik nuk ishte vërtetuar “përtej dyshimit të arsyeshëm”, përderisa pikat e mbetura të aktakuzës janë kthyer prapa në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, në pajtim me nenin 381 të LPP; Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu i ka liruar të akuzuarit nga paraburgimi dhe ka urdhëruar masa kufizuese të cilat përfundimisht i ka hequr Gjykatësi Kryesues me dy aktvendime pasuese të datës 28 Prill 2009 dhe 15 Korrik 2009.

Më 14 Prill 2009, Prokurori i EULEX-it Robert Dean ka ngritur një aktakuzë të ndryshuar kundër të tre të akuzuarve në të cilën pika e vetme e aktakuzës për Krime Luftë kundër Popullatës Civile është ndarë në tri nënpika që përfshijnë pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 13 dhe 14 të aktakuzës së parë. Avokatët mbrojtës kanë kundërshtuar aktakuzën, duke parashtruar që aktakuza e ndryshuar përfshinë akuza të cilat më nuk janë pjesë e *thema decidendi*.

Rigjykimi ka filluar më 7 Korrik 2009 përpara trupit gjykues në përbërje të lartcekur. Në praninë e të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, dhe pa praninë e asnjërës prej palëve të dëmtuara të cilat janë thirrur në mënyrë të rregullt, Kryetari i Trupit Gjykues ka konfirmuar që trupi gjykues është përbërë në pajtim me ligjin. Kompetencat e Gjykatësve të EULEX-it në këtë rast bazohen mbi dispozitat e Nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Çaktimin e Lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim ndaj përbërjes së trupit gjykues. Para leximit të aktakuzës, avokatët mbrojtës kanë përsëritur kundërshtimet ndaj aktakuzës së ndryshuar dhe, pas dëgjimit të argumenteve të palëve, trupi gjykues, për të vendosur, e ka shtyrë seancën gjyqësore për të nesërmen.

Më 8 Korrik 2009,

trupi gjykues ka lexuar aktvendimin me të cilin ka refuzuar aktakuzën e ndryshuar dhe, sipas nenit 390 LPP, ka përdorur aktakuzën fillestare dhe ndryshimet e saj pasuese në pjesën e kthyer mbrapa nga Gjykata Supreme si bazë për rigjykim; palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim dhe Prokurori ia ka lexuar aktakuzën të akuzuarve të cilët të gjithë janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.

Ditën e njëjtë Gjykata ka filluar procedurën e provave me marrjen në pyetje të akuzuarit të parë, Z. Latif Gashi.

Më 9 Korrik 2009,

procedura e provave ka vazhduar me marrjen në pyetje të dy të akuzuarve të tjerë, Nazif Mehmeti dhe Rustem Mustafa.

Më 10 Korrik 2009,

dëshmitarët [REDACTED] dhe [REDACTED] janë paraqitur dhe kanë dëshmuar përpara trupit gjykues.

Më 15 Korrik 2009,

dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e dhënë përpara gjykatësit hetues më 17 Korrik 2002 dhe deklarata e tij është lexuar për procesverbal; dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë;

Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e dhënë përpara gjykatësit hetues më 26 Korrik 2002 e cila është lexuar për procesverbal;

Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e dhënë përpara gjykatësit hetues më 25 Shtator 2002 e cila është lexuar për procesverbal; dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në një pyetje shtesë;

Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara gjykatësit hetues më 3 Maj 2002 dhe deklarata e dhënë përpara trupit gjykues më 23 Maj është lexuar për procesverbal; dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë. Dëshmitari [REDACTED] ka konfirmuar deklaratën e tij të mëparshme të dhënë përpara gjykatësit hetues më 27 Gusht 2002 dhe procesverbalin e dëshmisë së tij në shqyrtim gjyqësor më 22 dhe 23 Maj 2003; dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë; një dokument i propozuar nga avokati mbrojtës ku tregohet struktura e UÇK-së i është treguar dëshmitarit dhe është ofruar si provë.

Më 9 Shtator 2009.

dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara gjykatësit hetues më 3 Shtator 2002 dhe deklaraten e dhënë përpara trupit gjykues më 16 Qershor 2003; ai gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë; Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara gjykatësit hetues më 21 Gusht 2002 dhe deklaraten e dhënë përpara trupit gjykues më 12 Qershor 2003; dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë; Dëshmitari [REDACTED] i ka konfirmuar deklaratat e tij të mëparshme të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe përpara gjykatësit hetues; ai gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë.

10 Shtator 2009.

dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara trupit gjykues më 20 Maj 03; dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë; Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara trupit gjykues më 17 Qershor 2003; Dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë; [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e dhënë përpara gjykatësit hetues më 11 Korrik 2002; Dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë.

11 Shtator 2009.

dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara trupit gjykues më 15 Maj 2003; Dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë.

15 Shtator 2009.

Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara trupit gjykues më 17 Qershor 2003 përderisa e ka mohuar deklaratën e dhënë më 29 Tetor 2002 përpara gjykatësit hetues; Dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë; Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara trupit gjykues më 9 Mars 2003 dhe deklaraten e dhënë përpara gjykatësit hetues më 23 dhe 26 Mars 2002; Dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë; Dëshmitari [REDACTED] e ka konfirmuar deklaratën e mëparshme të dhënë përpara trupit gjykues më 31 Mars – 1 Prill 2003; Dëshmitari gjithashtu është përgjigjur në disa pyetje shtesë.

Më 18 Shtator 2009.

Gjykata ka shënuar në procesverbal si prova:

- Deklaratat e dëshmitarit "Q" të dhëna përpara gjykatësit hetues më 1 dhe 11 Shkurt 2002;
- Deklaratat e dëshmitarit [REDAKTUAR] të dhëna përpara gjykatësit hetues më 18 Korrik 2002;
- Deklaratat e dëshmitarit "4" të dhëna përpara gjykatësit hetues më 18 Tetor 2002 dhe procesverbali i dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor më 20 dhe 21 Mars 2003;
- Deklarata e dëshmitarit [REDAKTUAR] (fillimisht dëshmitari H) e dhënë përpara gjykatësit hetues më 6 Shkurt 2002 dhe procesverbali i dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor më 5 Maj 2003.

Gjithashtu, gjatë seancës së njëjtë Prokurori Publik i ka paraqitur trupit gjykues prova tashmë të ofruara gjatë gjykimit të parë të cilat janë të përfshira në dosjen e lëndës, siç janë paraqitur më parë:

- Prova nr. 4, "libri ngjyrë kafe";
- Prova 33, raporti i OSBE-së me titullin "siç është parë është treguar";
- Provat 26 dhe 27, dosjet mjekësore të [REDAKTUAR];
- Procesverbali i Këqyrjes së Vendit, që është kryer gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor më 27 Qershor 2003 dhe fotografitë e bashkangjitura, fotografitë 7, 8 dhe 9.

Më 30 Shtator 2009.

Gjykata ka dëgjuar fjalët përfundimtare të Prokurorit Publik, avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarve.

Më 02 Tetor 2009.

trupit gjykues ka shpallur aktgjykimin dhe, në pajtim me nenin 353 paragrafet 1) dhe 7) ka urdhëruar arrestimin e të akuzuarit Latif Gashi.

Gjetjet ligjore

Pas më shumë se gjashtë viteve nga ngritja e aktakuzës fillestare, pas dymbëdhjetë seancave gjyqësore dhe marrjes në pyetje të një numri të madh të dëshmitarëve, gjykimi i të tre të akuzuarve ka përfunduar.

Çështja, siç dihet, është paraqitur përpara Gjykatës së shkallës së parë për herë të dytë, pasi që Gjykata Supreme e Kosovës, me vendimin e saj të 21 Korrikut 2005, e ka "dërguar prapa për rigjykim" çështjen në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila tashmë kishte gjykuar Z. Latif Gashi, Z. Nazif Mehmeti dhe Z. Rustem Mustafa (së bashku me Z. Naim Kadriu) gjatë vitit 2003.

Gjykimi është zhvilluar qetë. Tensionimet që kanë qenë dukshëm të pranishme gjatë shqyrtimit gjyqësor në 2003 (si dhe gjatë hetimeve në 2002) dhe që mund të lexoheshin

në shumë paragrafe të marrjes në pyetje përpara gjykatësit hetues dhe në procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor, janë zhdukur.

Një numër faktorësh kanë kontribuar në ndryshimin e atmosferës në gjykatore.

Kalimi i kohës, në vend të parë, është qetësues dhe zbutës natyral i pasioneve dhe tensionimeve; Vet distanca kohore nga koha e ngjarjeve dhe nga shqyrtimi i kaluar gjyqësor, ka zvogëluar konfliktin në Gjykatore.

Ndërrimi i trupit gjykues është një faktor tjetër. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në shumë raste, tre të akuzuarit si dhe avokatët e tyre kanë paraqitur hetimet si një iniciativë të inspiruar ose së paku shumë të ndikuar nga shërbimet sekrete Serbe, të bazuara në pretendime dhe dëshmi të rreme. Gjithashtu është thënë që aktivitetet e hetuesve dhe prokurorëve të UNMIK-ut, dhe më vonë të gjykatësit hetues, kanë qenë një lloj trillimi që kanë pasur për qëllim diskreditimin e luftëtarëve që kanë luftuar kundër pushtuesit Serb. Është theksuar se praktika e përdorimit të përkthyesve Serb për të përkthyer deklaratat e dëshmitarëve (një pjesë shumë e madhe e tyre ishin të kombësisë Shqiptare) ka qenë e dëmshme dhe ka penguar mundësinë e mbështetjes në deklaratat të vërteta dhe të besueshme të dëshmitarëve. Sipas mendimit të avokatëve mbrojtës, gjykata e njëjtë e shkallës së parë, ka qenë viktimë e kësaj atmosfere të para-bindjes dhe paragjyqimit, dhe ka lëshuar një aktgjykim të bazuar në baza të rreme dhe të gabueshme. Çfarëdo qofitë natyra e këtyre pretendimeve, nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor ishte e qartë për të gjithë që të gjitha të lartpërmendurat nuk vlejnë sa i përket trupit të ri gjykues, të përbërë nga një gjykatës Kosovare dhe gjykatës të EULEX-it, dhe çfarëdo pretendimi i tillë sa i përket tyre do të ishte thjeshtë i pavend. Kjo ka pasur ndikim të mirë në atmosferën e shqyrtimit gjyqësor dhe ka hapur rrugën për një zhvillim të rregullt të procedurës.

Edhe një faktor tjetër duhet të llogaritet si kontribues thelbësor për një shqyrtim të drejtë gjyqësor. Sjellja e të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor, në Gjykatore dhe përjashta, ka qenë e patëmetë. Dihet se të tre të akuzuarit kanë luajtur një rol gjatë konfliktit në Kosovë, me nivele të ndryshme përgjegjësie, që i korrespondojnë qëndrimeve të tyre personale dhe eksperiencës së tyre jetësore. Dihet që angazhimi i tyre për komunitetin është zhvilluar më tej, pas përfundimit të luftës, dhe i ka sjell ata në pozita të reja me përgjegjësi dhe rëndësi. Duhet përsëritur faktin që para dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ata kanë e kanë vënë vetën në dispozicion të Gjykatës pa ngurrim, për të vetmin qëllim që të i shërbejnë drejtësisë dhe që atyre të ju shërbehet drejtësia.

Natyrisht, kjo është kuptuar dhe ka kontribuar shumë për një shqyrtim gjyqësor pa paragjykime nga asnjëra anë.

Gjykata Supreme e Kosovës, me vendimin e saj të 21 Korrikut 2005, ka “kthyer mbrapa për rigjykim” çështjen, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Fjalët që i ka përdorur shkalla më e lartë gjyqësore në Vend duhet të lexohen me kujdes dhe të interpretohen në mënyrë të drejtë, me qëllim që të kuptohet ndikimi i tyre në shqyrtimin e tanishëm gjyqësor.

Në faqen 2 të dokumentit, pika një e dispozitivit vërteton që vendimi i shkallës së parë “ANULOHEM NË TËRËSI” dhe çështja kthehet mbrapa për rigjykim”.

Në faqen e fundit të vendimit të njëjtë, ceket që “Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka zgjedhje tjetër veçse të kthej mbrapa tërë çështjen për rigjykim, në bazë të Nenit 385, Paragrafi 1 të LPP”.

Saktësisht çfarë domethënie kane shprehjet e përdorura? Dhe si përputhen me dispozitat e LPP-së?

Palët e kanë kuptuar dhe interpretuar vendimin në mënyra kontradiktore.

Në njërën anë, prokurori më 14 Prill 2009 ka paraqitur një aktakuzë të ndryshuar në të cilën ai i ka riformuluar, në tri nën-pika (A, B, C) akuzat nga aktakuza fillestare që kanë të bëjnë me: (i) kushtet çnjerëzore të paraburgimit në të cilat pretendohet të jenë mbajtur viktimat (pika A), (ii) rrahjet dhe torturimet në cilave pretendohet që i janë nënshtruar të ndaluarit (pika B) dhe (iii) vrasjet e pesë të ndaluarve (pika C). Duke vepruar kështu, prokurori gjithashtu ka përmendur në aktakuzë ngjarjet që pretendohet të kenë ndodhur në Majac dhe Potok, edhe pse të akuzuarit janë liruar nga akuzat përkatëse me vendim të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 16 Korrik 2003.

Në anën tjetër, avokatët mbrojtës kanë paraqitur (në përgjigjen e tyre me shkrim me datë 21 Prill 2009 dhe gojarisht, gjatë seancës së 7 Korrikut 2009) që rigjykimi nuk duhet të merret me disa pjesë substanciale të aktakuzës fillestare.

Në të vërtetë, ata të gjithë së bashku kanë vërejtur se gjykata e shkallës së parë, në vendimin e datës 16 Korrik 2003, ka liruar të tre të akuzuarit nga pjesët e pikave 5 dhe 8 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 Qershor 2003, do të thotë nga pretendimet që kanë të bëjnë me trajtimin çnjerëzor, rrahjet dhe torturimet që pretendohet të kenë ndodhur në Majac dhe Potok; pasi që prokurori nuk kishte paraqitur ankesë ndaj asaj pjese të vendimit, ato pretendime më nuk mund të shqyrtohen. Avokatët thonë që vendimi është bërë *res judicata*.

Gjithashtu, avokatët mbrojtës shtojnë se edhe pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës së ndryshuar më nuk mund të shqyrtohen në rigjykim, pasi që Gjykata Supreme në mënyrë të qartë “KA ANULUAR NË TËRËSI” (shkronja të theksuara në origjinalin e vendimit të Gjykatës Supreme) këto pika të aktakuzës. Z. Sylja prandaj ka arritur në përfundim që këto pika të aktakuzës “nuk janë të bazuara në ligj dhe në pajtim me Nenin 365, Paragrafi 1, dhe Nenin 363, Paragrafi 2, të Ligjit të Procedurës Penale, ato janë anuluar. Sipas gjetjeve të Gjykatës Supreme, sa i përket këtyre pikave të aktakuzës, rezulton që ka pasur shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit Latif Gashi sepse ai është gjykuar për vepra të cilat në të vërtetë nuk përbëjnë vepra penale. Për këto arsye ne si Avokatë Mbrojtës të

Latif Gashit mendojmë që ai nuk mund të gjykohet përsëri për këto Pika të aktakuzës. Pra aktakuza (*e re, e ndryshuar*) (e 14 Prillit 2009) nuk mund të qëndrojë, duke pasur parasysh Nenin 319, Nenin 3 dhe Nenin 378 të LPP” (Z. Mexhid Sylja, seanca e 7 Korrikut 2009).

Analiza e argumenteve të cilat i paraqesin avokatët mbrojtës e paraqet pjesën vijuese të vendimit ku Gjykata kupton që në çështje aplikohen principe të tjera gjyqësore.

Kur i referohen pjesëve të pikave 5 dhe 8 të aktakuzës së ndryshuar të 16 Korrikut 2003 (pretendimet që kanë të bëjnë me trajtimin çnjerëzor në Majac dhe Potok; pretendimet që kanë të bëjnë me rrahjet dhe torturimet në Majac dhe Potok), avokatët e Z. Gashi, Mehmeti dhe Mustafa theksojnë që përsëritja e shqyrtimit gjyqësor parandalohet nga fakti që prokurori nuk ka paraqitur ankesë ndaj asaj pjesë të vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e cila i kishte liruar klientët e tyre nga akuzat për keqbërje në Majac dhe Potok. Ata thonë që heqja dorë e prokurorit nga ankesa e ka bërë atë pjesë të vendimit të shkallës së parë *res judicata*, do të thotë diçka që, pasi që nuk i është nënshtruar rishikimit ose ankesës, është tani e paprekshme.

Përfundimi të cilin e kanë arritur avokatët është i saktë dhe Gjykata e ka konfirmuar atë në vendimin e saj të datës 8 Korrik 2009, i cili është lexuar gjatë seancës së mbajtur më 8 Korrik 2009. Këtu aplikohet principi *tantum devolutum quantum appellatum*, e jo ndalimi i *reformatio in pejus*, siç sugjeruan avokatët në propozimin e tyre të 21 Prillit 2009 (f. 4): principi i parë lë të kuptohet që gjykatësi që shqyrton ankesën mund të vendos vetëm mbi pjesën e vendimit (të shkallës së parë) e cila kundërshtohet nga cilado palë (pjesa tjetër bëhet *res judicata*) përderisa ndalimi i *reformatio in pejus* (neni 378 LPP) është një kufizim i fuqisë gjyqësore kur një ankesë, në fakt, paraqitet nga i akuzuari (“nëse ankesa është paraqitur vetëm në emër të akuzuarit...”).

Sa i përket pikave 1, 2, 3 dhe 12, argumenti i paraqitur nga avokatët mbrojtës është krejt ndryshe. Principi *tantum devolutum quantum appellatum*, ndalimi i *reformatio in pejus* ose definicioni i njëjtë i *res judicata* nuk mund të risjellet pa specifikim të mëtejshëm.

Aplikimi i principit *tantum devolutum quantum appellatum* do të ishte mospërputhës: avokatët në të vërtetë kanë paraqitur ankesë ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe ai ka qenë lëndë e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Pra, është ende pjesë e shqyrtimit gjyqësor dhe e aktakuzës mbi të cilën shqyrtimi gjyqësor duhet të arrij në vendim përfundimtar.

Ndalimi i *reformatio in pejus*, në anën tjetër, këtu është qartazi jashtë kontekstit: rigjykimi nuk është procedurë ankimore edhe nëse është pasojë e një vendimi të favorshëm të Gjykatës Supreme mbi ankesat e të pandehurve. Aplikimi i nenit 378 LPP, i imponuar nga neni 390.4 LPP, në rast të rigjykimit, do të thotë që gjykatësi në rigjykim, në fund të procedurës, nëse ai ose ajo gjen se i akuzuari është fajtor, nuk mund të dënojë të akuzuarin me një dënim burgimi më të rëndë se ai që është shpallur më parë ose që ai ose ajo nuk mund të vendos *ultra vires* (për shembull rishqyrtimi i pikave të aktakuzës ndaj të cilave nuk është paraqitur ankesë).

Përfundimisht, principi i *res judicata* mund të aplikohet vetëm pas një interpretimi të vendimit të Gjykatës Supreme.

Kur Gjykata Supreme shqyrton çështjen e Pikave 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës, Gjykata Supreme gjen që gjykata e shkallës së parë ka kuptuar tërësisht dhe saktësisht faktet e përshkruara nga prokurori si bazë e Pikave të aktakuzës por ajo ka gabuar në aplikimin e ligjit sa i përket atyre fakteve. Në vendim është cekur qartë që “akuzat nga Pika 1 e aktakuzës që janë gjetur si të vërtetuara në aktgjykim e shqyrtimit gjyqësor *nuk janë të bazuara në ligj*” (f. 12). Fjalët e njëjta përdoren edhe sa i përket Pikës 2, Pikës 3 dhe Pikës 12 të aktakuzës.

Për arsye të qarta, edhe nëse Gjykata Supreme nuk ka shpenzuar shumë faqe mbi këtë pikë, dhe e ka limituar vetën vetëm në paragrafin e cekur më lart, duhet supozuar që Gjykata Supreme e ka aprovuar interpretimin e fakteve relevante të bërë nga gjykata e shkallës së parë sepse përndryshe Gjykata Supreme nuk do të kishte vazhduar me kualifikimin ligjor të këtyre fakteve.

Përfundimi në të cilin ka arritur Gjykata Supreme duhet të merret si përfundimtar dhe jo si çështje për rigjykim. Përkundër faktit që e njëjta Gjykatë Supreme ka “kthyer prapa tërë çështjen për rigjykim” (f. 20 e vendimit të Gjykatës Supreme), qëllimi i vërtetë i Gjykatës Supreme shfaqet nga mënyra e qartë në të cilën ajo shprehë konceptin që akuzat nga Pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës “ANULOHEN NË TËRËSI” (shkronja të mëdha, të theksuara të përdorura në origjinal), për të bërë të qartë që ngjarjet e përshkruara në pikat e aktakuzës më nuk duhet të jenë lëndë e shqyrtimit gjyqësor.

Kjo zgjidhje mund të shkaktoj kundërshtime. Mund të vërehet që Gjykata Supreme është dashtë të aplikojë nenin 387 LPP, i cili cekë që “Gjykata e shkallës së dytë do të ndryshojë aktgjykimin *(duke liruar të akuzuarin nga Pika 1, 2, 3 dhe 12 e aktakuzës, në këtë rast)* nëse gjen që *faktet vendimtare janë vërtetuar saktësisht në aktgjykimin e shkallës së parë dhe që duke pasur parasysh gjendjen faktike siç është vërtetuar duhet të lëshohet një vendim ndryshe kur ligji aplikohet në mënyrë të drejtë...*”. Mund të shtohet që Gjykata Supreme është dashtë të bëj më mirë dallimin në dispozitiv në mes të pikave të aktakuzës që janë anuluar në tërësi (1, 2, 3, 12) dhe atyre ku kjo nuk ka ndodhur.

Duke e dërguar tërë çështjen në rigjykim dhe duke mos specifikuar se cilat pika të aktakuzës është dashtë të rigjyken dhe për cilat pika vendimi ishte lirues, Gjykata Supreme mund të ketë kryer një pasaktësi (çështja nuk është dashtë të dërgohet prapa për rigjykim *në tërësi*). Megjithatë, nëse nuk është cekur qartë në dispozitiv, është e padiskutueshme që fjalët që i ka përdorur Gjykata Supreme sa i përket pikave 1, 2, 3, 12 (*akuzave të anuluar në tërësi*) përbëjnë një aktgjykim lirues. Gjithashtu, është e padiskutueshme, duke pasur parasysh fjalët e qarta që i ka përdorë Gjykata Supreme, që në fund të rigjyimit, ky trup gjykues nuk ka mundur të vërtetojë faktet e përshkruara në pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës në një mënyrë ndryshe nga vlerësimi i Gjykatës Supreme dhe nuk ka mundur të interpretojë ligjin në mënyrë divergjente.

Në këtë linjë, vendimi i Gjykatës Supreme sa i përket fakteve të akuzës nga Pikat 1, 2, 3 dhe 12 është *res judicata* dhe për këtë arsye faktet e përshkruara aty nuk mund të i nënshtroheshin një shqyrtimi të mëtejshëm gjyqësor. Do të ishte e papërshtatshme, kundër çfarëdo shpjegimi të arsyeshem, dhe burim i konfuzionit dhe pasigurisë ligjore nëse ky trup gjykues do të kishte gjykuar përsëri faktet që Gjykata Supreme e Kosovës i ka kualifikuar në mënyrë të qartë si të ligjshme. Po të vendoste ky trup gjykues në kundërshtim me gjetjet e Gjykatës Supreme, do të vijonin kundërshtime dhe zhvlerësime në administrimin e drejtësisë.

Përfundimi të cilin e ka arritur ky trup gjykues ndaj kërkesave të avokatëve mbrojtës sa i përket Pikave 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës duhet të çoj në pasojat e tij logjike.

Principi i mos kundërshtimit i imponon kësaj gjykate interpretimin dhe leximin e të gjitha pjesëve të ndryshme të vendimit të Gjykatës Supreme në të njëjtën mënyrë.

Veçanërisht, sa i përket Pikës 8 të aktakuzës, ky trup gjykues vëren që Gjykata Supreme ka gjetur që vendimi i trupit gjykues i 16 Korrikut 2003 është i saktë dhe si pasojë ka gjetur të pabazuara ankesat e avokatëve mbrojtës të të akuzuarve mbi këtë çështje.

Zgjidhja e adoptuar nga Gjykata Supreme është e qartë dhe e lirë nga dykuptueshmëritë. Fjalët e përdorura nga instanca supreme gjyqësore e Vendit sa i përket akuzave për rrahje dhe torturime të kryera nga të akuzuarit, në kapacitetet e tyre përkatëse, në Llapashticë, nuk lënë hapësirë për interpretim.

Gjykata Supreme (f. 15 e vendimit) së pari i ka risjellë akuzat (nga pjesa që ka mbetur) e pikës 8 të aktakuzës, pastaj ka shqyrtuar rikonstruksionin e fakteve të bërë nga trupi gjykues, duke analizuar argumentet e ankesave të akuzuarve ndaj vendimit mbi këtë pikë të aktakuzës (lidhur, siç mund të lexohet në ankesat dhe siç është kujtuar në vendim, me dëshminë e dëshmitarëve anonim). Përfundimisht, Gjykata Supreme ka arritur në përfundim që çështjet e ngritura në ankesa "janë pa vlerë" dhe që "të drejtat e të pandehurve siç parashihen në Nenin 6(3) të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut nuk janë shkelur dhe trupi gjykues në mënyrë të drejtë ka bazuar gjetjet e tij mbi dëshminë e këtyre dëshmitarëve".

Përkundër gjetjes se ankesat janë pa vlerë, Gjykata Supreme ka dërguara mbrapa "tërë çështjen për rigjykim". Zgjidhja është adoptuar nga Gjykata Supreme për arsye të shprehura në faqen e fundit të vendimit: "aktgjykimi i shqyrtimit gjyqësor ka trajtuar pikat e ndryshme në...aktakuzë...si një krim luftë të vetëm sa i përket secilit të pandehur...Duke i trajtuar si një krim luftë i vetëm dhe duke imponuar dënimet në përputhje me rrethanat, Gjykata Supreme e Kosovës *nuk ka zgjedhje tjetër pos* (theksimi i shkronjave Italike është shtuar) të dërgoj mbrapa tërë çështjen për rigjykim, në bazë të Nenit 385, Paragrafi 1 të LPP". Me fjalë tjera, Gjykata Supreme ka identifikuar një pengesë të pakapërcyeshme ndaj marrjes së vendimit të saj përfundimtar mbi Pikën 8 të aktakuzës, në rrethanën që trupi gjykues i shkallës më të ulët i ka kualifikuar faktet e

ndryshme penale të përshkruara në aktakuzë si një krim unik, që prandaj kërkon një vendim unik.

Zgjidhja e adoptuar nga Gjykata Supreme mund të shqyrtohet në ligj por nuk mund të kundërshtohet nga ky trup gjykues. Gjykata Supreme ka konfirmuar që vendimi i trupit gjykues mbi faktet e përshkruara në Pikën 8 të aktakuzës është i drejtë.

Gjithashtu, duhet thënë që Gjykata Supreme jo vetëm ka konfirmuar faktet e përshkruara në pikën 8 të aktakuzës, në Llapashticë, por gjithashtu ka dhënë edhe kualifikimin ligjor të këtyre fakteve.

Në të vërtetë, nuk mund të na ikë që në paragrafin me titull **Shqyrtimi ex officio i ligjit të aplikueshëm ndërkombëtar** (me shkronja të theksuara dhe nënvizuara në origjinal, f. 5), Gjykata Supreme ka shpjeguar bollshëm, nga faqja 5 deri në faqen 11, suazën ligjore të vendimit, duke ilustruar ligjin ndërkombëtar dhe vendor të aplikueshëm në këtë çështje.

Kjo gjendje e fakteve është detyruese për këtë trup gjykues, i cili nuk mund të heq nga kualifikimi faktik dhe ligjor i dhënë nga Gjykata Supreme mbi pikën 8 të aktakuzës.

Sikur që ndodh sa i përket Pikave 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës, edhe kjo pjesë vendimit të Gjykatës Supreme duhet të merret si *res judicata* nga Gjykata e shkallës më të ulët, e cila prandaj nuk është në pozitë që të kundërshtojë vendimin e gjykatës më të lartë mbi vlerësimin e saj të fakteve dhe interpretimin e ligjit sa i përket Pikës 8 të aktakuzës.

Në thelb, për Pikën 8 të aktakuzës, detyra e këtij trupi gjykues është e kufizuar, dhe është vetëm të caktojë dënimin, dhe Gjykata Supreme ka gjetur që është e parandaluar nga kjo, në bazë të interpretimit që i është dhënë Nenit 385 LPP në faqen e fundit të vendimit të saj. Unifikimi i drejtuar nga trupi gjykues i të gjitha fakteve në një krim të vetëm lufte është parë nga Gjykata Supreme si një kufizim ndaj aplikimit të nenit 367 LPP dhe shpalljes së një vendimi që përcakton dënimin e duhur për faktet e përshkruara në pjesën e mbetur të Pikës 8 të aktakuzës (rrahjet dhe torturimet në Llapashticë). Duke përdorë shprehjen "Gjykata Supreme e Kosovës *nuk ka zgjedhje tjetër* pos që dërgoj mbrapa tërë çështjen për rigjykim", Gjykata ka treguar që nuk ka pasur asnjë zgjidhje tjetër në dispozicion dhe që prandaj ka qenë e "detyruar" të bëjë këtë.

Dhe tani, një çështje e fundit sa i përket pikës 8, sa për të parandaluar dykuptueshmëritë.

Mund të mos jetë befasi për palët që mendimi i këtij trupi gjykues sa i përket pikës 8 ishte ai që u shfaq më lart dhe që prandaj fare nuk ka pasur nevojë që të merren në pyetje dëshmitarët gjatë rigjyimit, pasi që faktet dhe ligjin i ka vërtetuar Gjykata Supreme. Ky ka qenë një orientim që i është bërë i qartë palëve me qëllim që të justifikohet rrethana që qe nuk ishte pranuar asnjë dëshmitarë, mbi faktet e përshkruara në pikën 8 (sa i përket Llapashticës). Palëve i është bërë e qartë gjatë seancës së 9 Korrikut 2009, siç e ka njohur Prokurori në fjalën e tij përfundimtare. Dhe i është bërë e qartë palëve gjithashtu gjatë takimit të mbajtur më 24 Korrik, të mbajtur pikërisht për qëllim të përcaktimit, duke

pasur parasysh parashtrirat e palëve, listën e dëshmitarëve që duhet të thirren në shqyrtim gjyqësor.

Lista e dëshmitarëve dhe arsyet e dhëna në ato raste nuk kanë ngritur asnjë shqetësim për Avokatët Mbrojtës në atë kohë e as gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prandaj ishte argument i papritur dhe i pabesueshëm argumenti i avokatit mbrojtës Z. Sylja, gjatë fjalës së tij përfundimtare, i cili kërkoi lirimin e klientit të tij nga pika 8 e aktakuzës...sepse asnjë dëshmitar nuk është dëgjuar nga Gjykata mbi faktet e përshkruara në pikën e aktakuzës.

Argumentet e përdorura në paragrafin paraprak sa i përket pikës 8 mund të përdoren në mënyrë të barabartë edhe sa i përket Pikës 11 të aktakuzës.

Gjykata, siç dihet, merret me vrasjet e pretenduara të pesë të ndaluarve nga ana e të akuzuarve.

Përderisa trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut i ka shpallur të akuzuarit Gashi, Mehmeti dhe Mustafa fajtorë për akuzën, trupi gjykues i shkallës së dytë ka pasur një qasje krejtësisht ndryshe në vlerësimin e provave.

Në thelb, Gjykata Supreme ka gjetur që trupi gjykues nuk ka pasur në dispozicion asnjë provë të drejtpërdrejtë mbi disa aspekte kyçe të ngjarjeve të përshkruara në Pikën 11 të aktakuzës: "...nuk ka asnjë provë në procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor që ndonjë dëshmitar të ketë dëgjuar, ose të ketë pasur njohuri personale, për një urdhër që Rrustem Mustafa ia ka dhënë Nazif Mehmetit që pesë viktimat të...vriten"; "...nuk ka asnjë provë në procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor që ndonjë dëshmitar të ketë dëgjuar ose të ketë pasur njohuri personale për ndonjë urdhër që e ka dhënë Nazif Mehmeti...për të vrarë pesë viktimat"; "...nuk ka asnjë provë në procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor që ndonjë dëshmitar të ketë vërejtur vrasjen e ndonjërit prej pesë...të paraburgosurve".

Për më tepër, Gjykata Supreme ka vërejtur që trupi gjykues, në vendimin e tij, nuk i ka shqyrtuar në mënyrë specifike aspektet e cekura. Gjykata Supreme në të vërtetë thotë që sa i përket urdhrave të supozuar për të vrarë dhe vet vrasjeve "Në aktgjykimin e shqyrtimit gjyqësor nuk është asnjë gjetje...". Gjykata pastaj përfundon që "Gjetjet në aktgjykimin e shqyrtimit gjyqësor që akuzat nga Pika 11 e aktakuzës janë bazuar vetëm në prova rrethimore.

Në bazë të këtij përfundimi (vetëm prova rrethimore për Pikën 11) Gjykata më tej shpjegon që pas marrjes së vendimit mbi prova rrethimore e jo prova të drejtpërdrejta, trupi gjykues është dashtë që të përjashtojë përfundimet e tjera të mundshme. Me fjalë tjera, kur në dispozicion janë vetëm provat rrethimore, kjo nuk mjafton për të arritur përfundime logjike pozitive mbi përgjegjësinë e të akuzuarve nga të dhënat që janë në dispozicion, por nga Gjykata kërkohet një proces i mëtejshëm mendor, i cili përbëhet nga rregulli i përjashtimit të përfundimeve të tjera të mundshme alternative që mund të ishin arritur nga të dhënat. Vetëm kur të plotësohet ku standard më i lartë, mund të deklarohet që është arritur pragu i fajësisë përtej dyshimit të arsyeshëm.

Kjo gjykatë e shkallës më të ulët pajtohet me argumentin e Gjykatës Supreme dhe beson që edhe kjo pjesë e vendimit duhet të merret si përfundimtare. Një aktgjykim i shkallës së dytë i cili vërtetohet që nuk mund të arrihet fajësia përtej dyshimit të arsyeshëm korrespondon me një aktgjykim përfundimtar lirues mbi çështjen. Parimi i ndalimit të gjykitimit dy herë për të njëjtën vepër apo *ne bis indem*, që parashihet në nenin 34 të Kushtetutës së Kosovës dhe në një numër instrumentesh ligjore në nivel ndërkombëtarë (Pakti mbi të Drejtat Civile dhe Politike, KEDNJ, ...), duhet të gjej aplikim praktik në këtë çështje. Nëse Gjykata Supreme nuk ka gjetur elementet bazike për të konfirmuar përgjegjësinë e të akuzuarve për Pikën 11, nuk ekziston asnjë arsye për të cilën vet të akuzuarit duhet të i nënshtrohen përsëri një përvojë të hidhur si një shqyrtim gjyqësor, veçanërisht nëse përshihen akuza aq të rënda dhe, për disa aspekte, të turpshme.

Në fund, nëse Gjykata e shkallës më të lartë deklaron që "Nuk ka asnjë provë përtej dyshimit të arsyeshëm që Rustem Mustafa ka urdhëruar Nazif Mehmetin që të sigurojë vrasjen e pesë viktimave. Nuk ka asnjë provë përtej dyshimit të arsyeshëm që Nazif Mehmeti ka urdhëruar një apo disa persona të panjohur dhe të paidentifikuar që të kryejnë vrasjen e pesë viktimave", kjo do të thotë që vendimi duhet të merret si përfundimtar; në anën tjetër, është e vështirë të besohet që një proces i përtërirë mendore (që është në thelb procesi logjik i arritjes së përfundimeve nga të dhëna të thjeshta të provave indirekte ose rrethanore) i kryer nga ky trup gjykues sot do të mund të mbushte zbrazëtinë që Gjykata Supreme e ka identifikuar në vendimin e trupit të parë gjykues.

Për këto arsye, është vendosur si në aktvendimin e 8 Korrikut 2009.

Trupi gjykues ka ilustruar, në faqet e mëparshme, arsyet pse Pika 8 e aktakuzës trajtohet si tashmë e gjykuar nga Gjykata Supreme. Është shpjeguar që principi i njëjtë në të cilin u thirrën avokatët në lidhje me Pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës gjen aplikim sa i përket Pikës 8 dhe gjithashtu edhe Pikës 11, ashtu që principi i mos kundërshtimit i imponon Gjykatës që të trajtojë situatat identike në të njëjtën mënyrë.

Nga kjo, vijon që faktet e përshkruara në Pikën 8 (dhe 11) të aktakuzës duhet të trajtohen si fakte të gjykuara, mbi të cilat hetimi i mëtejshëm gjyqësor gjatë shqyrtimit gjyqësor është i panevojshëm dhe ai duhet të mënjanohet.

Për ata që mund të mbesin të hutuar nga interpretimi i kësaj Gjykate, mjafton të thuhet që asnjë zgjidhje tjetër logjike nuk ka qenë e pranueshme dhe që interpretimi i kësaj Gjykate është interpretimi më logjik.

Çfarë opsione tjera ishin në dispozicion?

Rigjykim mbi të gjitha pikat e aktakuzës?

Kjo ishte zgjidhja e propozuar nga Prokurori kur ai e ngriti aktakuzën e re, e cila përfshinte edhe faktet që tashmë i kishte hedhur poshtë Gjykata e shkallës së parë në 2003.

Duke vepruar kështu, Prokurori ka aplikuar në kuptimin e plotë të fjalës principin e konfirmuar nga Gjykata Supreme.

Vendimi i Gjykatës Supreme, në faqen 2, në fund, në dispozitiv, pika 1, cekë qartë "Aktgjykimi...i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë "ANULOHEM NË TËRËSI (shkronjat e mëdha të përdorua në origjinal) dhe çështja dërgohet mbrapa për rigjykim"; në faqen e fundit ajo nxjerrë përfundimin "Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka asnjë zgjedhje tjetër pos që të kthej mbrapa tërë çështjen për rigjykim".

Nga kjo pikëpamje, Prokurori me të drejtë e ka marrë aktakuzën fillestare, në tërësi, dhe vetëm i ka ndryshuar fjalët: nëse vendimi i shkallës së parë hidhet poshtë, gjithçka duhet të rifillojë përsëri, dhe procedura duhet të kthehet te akti i fundit i vlefshëm para anulimit të vendimit.

Por kjo zgjidhje nuk mund të ishte në pajtim me historinë e shqyrtimit gjyqësor. Në fakt, rrethana që Prokurori nuk ka paraqitur ankesë ndaj pjesëve liruese të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë më nuk është e kundërshtueshme, ashtu që shprehja (e përdorur nga Gjykata Supreme) "çështja dërgohet mbrapa për rigjykim" është dashtë të interpretohet dhe të limitohet në pjesën e çështjes e cila i është prezantuar Gjykatës Supreme dhe jo në tërësinë e saj fillestare. "Çështja", me fjalë tjera, të cilës i referohet Gjykata Supreme në paragrafin e përmendur, është çështja të cilën e ka përpara dhe jo çështja, siç është përcaktuar fillimisht me aktakuzën e 30 Qershor 2003.

Sipas logjikës së njëjtë, interpretimi i vendimit të Gjykatës Supreme na imponon që të përjashtojmë nga lënda e shqyrtimit gjyqësor ato pjesë të aktakuzës të cilat janë "anuluar në tërësi" nga ana e Gjykatës Supreme, edhe nëse "çështja është dërguar mbrapa për rigjykim". A do të kishte kuptim që të merren në pyetje dëshmitarët dhe të dëgjohen argumentet e palëve në lidhje me pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës, kur është e qartë dhe e vërtetuar që Gjykata Supreme ka gjetur që faktet që janë përshkruar në to nuk përbëjnë asgjë të paligjshme? Pasi që trupi gjykues është i kufizuar nga interpretimi i dhënë nga Gjykata Supreme sa i përket fakteve dhe ligjit, ai nuk ka mundur që, në fund të procedurës së provave, të jep një përshkrim ndryshe të fakteve e as që të ju jep kualifikim tjetër ligjor. Pra, çfarë kuptimi do të kishte shfrytëzimi i burimeve gjyqësore nëse zgjidhja e çështjes nuk është e duart e këtij trupi gjykues?

Në fund, gjithashtu mbi pikën 8 të aktakuzës, pasi që Gjykata ka vërtetuar që faktet janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe që ligji është aplikuar në mënyrë të drejtë, pse do të duhej që ky trup gjykues të merr përsëri në pyetje dëshmitarët?

Nuk mund të fshihet që, duke vepruar kështu, ky trup gjykues shtie një sasi lirie veprimi në interpretimin e vendimit të Gjykatës Supreme (sepse i trajton pikat 8 dhe 11 në të njëjtën mënyrë siç janë trajtuar pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës), përkundër faktit që

Gjykata Supreme ka vendosur që “të kthej mbrapa tërë çështjen për rigjykim” (faqja 20). Por ky është çmimi që duhet paguar për hir të koherencës së sistemit.

Mbi premisën e asaj që u tha deri tani, skenari ligjor në të cilin duhet të vendosen faktet e përshkruara në akuzë bëhet i qartë.

Gjithashtu sa i përket këtij aspekti, trupi gjykues është i kufizuar nga vendimi i Gjykatës Supreme; siç dihet, aplikueshmëria e Konventave të Gjenevës në Kosovë gjatë konfliktit nuk kontestohet dhe është konfirmuar qartë nga Gjykata Supreme e cila vëren që: katër Konventat e Gjenevës janë miratuar nga Republika Popullore e Jugosllavisë më 21 Prill 1950; përderisa protokollet shtesë I dhe II janë miratuar më 8 Qershor 1977, dhe kanë hyrë në fuqi më 7 Dhjetor 1978, prandaj të gjitha kanë qenë në fuqi në Kosovë që nga 22 marsi 1989, që përfshinë periudhën e konfliktit të armatosur.

Karakter i jo-ndërkombëtar i konfliktit, i cili përfundimisht konfirmohet nga Gjykata Supreme, urdhëron aplikimin e Neni të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës, që cakton garancitë minimale në raste të *konfliktit të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar dhe që ndodhë në territorin e njëres prej Palëve të Larta Kontraktuese*,¹ dhe Protokolli Shtesë II, i cili zhvillon dhe plotëson Nenin 3.² Gjykata Supreme ka konfirmuar që Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës dhe Protokolli Shtesë II janë aplikuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje.

Gjykata Supreme gjithashtu ka konfirmuar disa gjetje faktike dhe ligjore, siç janë përcaktuar nga trupi gjykues i shkallës së parë, të cilat ky trup gjykues i rigjykimit nuk do të ri-vlerësojë; në veçanti, Gjykata Supreme ka konfirmuar:

- a. Ekzistimin e konfliktit të armatosur në Kosovë në kohën për të cilën bëhet fjalë;
- b. Ekzistimin e një lidhje në mes të konfliktit të armatosur dhe krimeve të pretenduara;
- c. Statusin e viktimës si person i mbrojtur sipas konventave të Gjenevës;
- d. Që pretendimet faktike të pikave të mbetura të aktakuzës shkelin: edhe ligjin vendorë edhe rregullat e aplikueshme të ligjit ndërkombëtarë që ishin në fuqi në – testin e dualitetit-, kohën e luftës, konfliktit të armatosur ose pushtimit.

Ky trup gjykues pranon që janë përmbushur elementet e përgjithshme të neni 142 KP RSFJ dhe kjo është e lidhur në kualifikimin ligjor të veprës, me rregullën e çiftuar të ligjit ndërkombëtar të identifikuar nga Gjykata Supreme.

Përveç kësaj, ky trup gjykues vëren që elementet e lartpërmendura nuk janë kundërshtuar asnjëherë dhe nga asnjëra palë gjatë procedurës.

¹ Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës, presje I

² Protokolli Shtesë II i Konventave të Gjenevës, Neni I

Përfundimisht, trupi gjykues ka konsideruar edhe çështjen e formave të aplikueshme të përgjegjësisë kur ka vlerësuar përgjegjësinë e të akuzuarve për veprat e kryera penale; përfundimet që janë nxjerrë nuk janë hedhur poshtë nga Gjykata Supreme. Sa i përket Pikës 8, atëherë, rolet e ndryshme të akuzuarve në ngjarje janë vërtetuar dhe fiksuar në kushtet e theksuara në vendimet e mëparshme.

Siç do të thuhet shkurtimisht, pjesëmarrja e tyre në një ndërmarrje të përbashkët kriminale nuk e kriminalizon tërë UÇK-në e as nuk e karakterizon UÇK-në si një organizatë kriminale – siç parashtuan avokatët e të akuzuarve në fjalët e tyre përfundimtare.-por thjesht e identifikon mënyrën specifike të bashkë-kryerjes së krimeve.

Para se të fillojmë shqyrtimin e qdo pike te aktakuzës, duhet ti shpenzojmë disa fjalë për të vënë ngjarjen në kontekst.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në disa raste, avokatët mbrojtës dhe të vet të akuzuarit i janë përgjigjur akuzave dhe kanë shprehur shqetësimet e tyre për atë që ata e konsideronin si pasojën më të rëndë dhe më dëmtuese të shqyrtimit gjyqësor dhe të vendimit të shkallës së parë dhe asaj të dytë.

Në një fjalë, ata të gjithë janë ankuar që është e neveritshme dhe tragjike, dhe indikator i padrejtësisë që po bëhet, që ata që ishin pjesëtarë të ushtrisë çlirimtare, dhe jo Serbët, janë sjell përpara Gjykatës.

Ky argument është shprehur në mënyrë të përsëritur, në mënyrë të sinqertë, pa tentime që të krijohet një shtjellim i sofistikuar i mendimit.

Gjykatës i është tërhequr vëmendja që prova më e drejtpërdrejtë e mungesës së besueshmërisë së akuzave është fakti që Shqiptarët, në vend të Serbëve, janë duke iu përgjigjur akuzave për krime lufte, përkundër faktit që Serbët kanë qenë shtypësit dhe që Shqiptarët u çliruan nga zgjedha e Beogradit vetëm nëpërmes luftës çlirimtare.

Trupi gjykues e ka kuptuar që të akuzuarit sinqerisht e kanë konsideruar këtë si rrethanën më shkatërruese dhe ofenduese.

Është lehtë që të kuptohet.

Përtej një përshkrimi të thjeshtë të fakteve siç janë rrahjet, kufizimi i lirive dhe torturimet, akuza është për shkelje të konventave të Gjenevës, që sjell kualifikimin e krimit të luftës. Tani, për njerëz që kanë luftuar për pavarësi dhe të cilët në përgjithësi konsiderohen si heronj për atë që e kanë bërë dhe për atë që e kanë arritur, që ata të quhen kriminel lufte, që të vendosen në të njëjtin nivel si njerëzit e gjykuar nga tribunalet ndërkombëtare në Nuremberg ose në Hagë, ishte qartazi e papranueshme.

Me thjeshtësim i cili ndonjëherë i nevojitet një argumenti retorik, është thënë që Serbët duhet të konsiderohen si kriminel luftë, e jo Shqiptarët dhe që "si u bë që ata që kanë luftuar për lirinë e popullit tani vendosen në të njëjtin nivel si ata që e kanë shtypur atë?" Është shtuar që Historinë nuk mund ta shkruaj një Gjykatë, me konkluzionin që në rast të një vendimi të pafavorshëm ndaj të akuzuarve, besueshmëria e Gjykatës, e jo e akuzuarve, do të rrezikohet.

Përgjigja e Gjykatës ndaj këtij argumenti nuk do të jetë shumë e gjatë.

Trupi gjykues konsideron që nuk është e nevojshme që të futet në një disertacion të gjatë, ku do të identifikonte dhe përshkruante gjerësisht rrethanat në të cilat është shpalosur historia e këtij Vendi, gjatë dekadave kur raportet në mes të dy komuniteteve kryesore, Shqiptarëve dhe Serbëve, përkeqësoheshin në mënyrë progresive.

Një dekadë pasi që kanë ndodhur ngjarjet dhe pasi që ka përfunduar konflikti, është koha e duhur që gjërat të shihen në një mënyrë më të ftohtë. Përderisa është e pakontestueshme që gabimet dhe teprimet mund të jenë kryer edhe nga ana e Shqiptarëve, premisa është që gjërat duhet të mbahen në proporcion.

Dhe nëse i vendosim gjërat në perspektivën e duhur, vështirë që mund të kontestohet që proporcioni në mes të viktimave Shqiptare të luftimeve dhe të shtypjes që ka paraprirë konfliktin, dhe viktimave Serbe, është jashtëzakonisht në dëm të grupit të parë. Vështirë që mund të kontestohet që ballafaqimi përfundimtar është paraprirë nga një dekadë e politikës së dorës së hekurt dhe diskriminimit sistematik ndaj Shqiptarëve në çdo nivel të administratës publike dhe të shoqërisë.

E vërteta e qartë, sa i përket konfliktit dhe luftimeve që kanë paraprirë 24 Marsin 1999, është që shumica e burimeve të ndryshme na tregojnë që proporcioni në mes të viktimave Shqiptare dhe Serbe (në këtë llogaritje përshihen vdekjet dhe zhdukjet) është rreth gjashtë ose shtatë me një.

Por konsideratat e mëparshme nuk përjashtojnë që ky shqyrtim gjyqësor ka justifikimin dhe legjitimitetin e tij.

Ky shqyrtim gjyqësor asnjëherë nuk ka pretenduar të jetë fjala e fundit mbi ngjarjet që kanë ndodhur për vite të tëra në Kosovë. Gjykatësit nuk e kanë këtë funksion, e as nuk kanë instrumente që të arrijnë këtë.

Ajo që ky shqyrtim gjyqësor tenton që të arrijë është një vlerësim i drejtë i fakteve që i kanë ofruar këtij trupi gjykues për vlerësim, asgjë më pak as më shumë.

Natyrisht, Gjykata është e vetëdijshme për Historinë e këtij Vendi dhe për ngjarjet e dekadave të fundit. Mund të thuhet që ata (Historia dhe ngjarjet e dekadave të fundit) janë skenari në të cilin kanë ndodhur faktet e përshkruara në aktakuzë. Ato janë të njohura dhe ato merren parasysht nga Gjykata.

Nëse ato gjithashtu përbëjnë një parakusht për kualifikimin ligjor të akuzave (pa konflikt në Vend, nuk ka krim luftime), ato nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi kualifikimin ligjor të fakteve të përshkruara në secilën pikë individuale të aktakuzës. Ose së paku ato nuk mund të përdoren nga të akuzuarit si një mbrojtje e përgjithshme. Argumenti “ne kemi qenë në luftë, dhe luftën nuk e kemi shkaktuar ne” nuk shkon aq larg sa që ti bëj thirrje “*omnia licet in bello*” që nuk mund të parashtrohet dukshëm si justifikim. As rrethana që autoritetet Serbe kanë drejtuar një fushatë të asgjësimit dhe të spastrimit etnik të popullatës Shqiptare në Kosovë (dhe veçanërisht, në rajonin e Llapit) nuk mund të përbëjë një *excusatio* të përgjithshme për sjellje të cilat në rrethana normale do të ishin të paligjshme. Imoraliteti dhe paligjshmëria e shtypjes dhe e agresionit nuk e autorizojnë viktimën (qoftë popullatën e përgjithshme apo një individ të vetëm) që të silllet në mënyrë të ngjashme sepse nuk mund të ketë apostrofim në mes të dy paligjshmërive. Rrethana që dikush vepron në mënyrë të paligjshme nuk më lejon edhe mua që gjithashtu të vepron në mënyrë të paligjshme, as në rastin ku unë e drejtoj (sjelljen time të paligjshme) ndaj tij. Dy padrejtësi nuk e bëjnë një të drejtë.

Gjithashtu, nëse merret si thirrje, për ndonjë profil, për një gjendje të domosdoshmërisë ose edhe për vetëmbrojtje, do të thotë një kushtë që i heq paligjshmërinë sjelljes së kontestuar, argumenti nuk është bindës.

Që vetëmbrojtja (*vim vi repellere licet*) ose gjendja e domosdoshmërisë (*necessitas legem non habet*) të jenë operative, gjendja e një rreziku të brendshëm dhe përpjesëtimi në mes të sulmit ndaj integritetit fizik dhe mbrojtjes duhet të jenë të pranishëm.

Tani, në të gjitha sjelljet e përshkruara në aktakuzë këto parakushte për vetëmbrojtje/gjendje të domosdoshmërisë nuk paraqiten.

Nuk mund të mos vërehet që pikat e vetme të mbetura të aktakuzës më nuk i referohen paraburgimit në vetvete (i cili nuk është konsideruar i paligjshëm nga Gjykata Supreme: pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës) por i referohen modalitetit të atij paraburgimi.³

Pra, nëse bëhet fjalë për modalitetet e paraburgimit dhe jo vet paraburgimin, ku është mundësia që torturimet e pretenduara në aktakuzë (pikat 8, 9 dhe 14) ose vuajtjet e përshkruara në pikën 5 janë shkaktuar nga një rrezik i afërt ose i brendshëm? Nëse është e argumentueshme dhe e justifikueshme që paraburgimi ka qenë i domosdoshëm për të parandaluar bashkëpunëtorët nga zbulimi i lokacioneve të sakta të forcave të UÇK-së të autoritetet Serbe (sjellje që, siç ka thënë GJS, ka qenë e lejueshme), nuk mund të ketë justifikim të tillë për torturime dhe privim nga kushtet adekuate të atyre që mbaheshin në paraburgim.

³ Në këtë vendim përdoret fjala paraburgim, për tri arsye: i) është përdorur gjatë hetimeve, në aktakuzë dhe natyrisht në shqyrtim gjyqësor; nëse ndryshohet tani, kjo vetëm do të krijonte konfuzion; ii) “ndalimi” në Shqip mund të ketë, me të vërtetë, një konotacion më neutral por gjithashtu mund të përdoret në mënyrë teknike për të treguar për një ndalim prapa grilave; iii) në Anglisht, vetëm një fjali më e gjatë, jo e përdorimit praktik, mund të jetë zëvendësim adekuat: për shembull “deprivation of liberty” (heqja e lirisë).

Edhe më pak mund të thuhet që justifikimi për veprime si ato të përshkruara në aktakuzë mund të gjendet në një lloj suspendimi të ligjshmërisë, një lloj *etat d'exception* të imponuar nga kushtet në të cilat ndërluftuesit kanë ballafaquar veten.

Së pari, siç do të shohim, së paku deri në ditën kritike të 24 Marsit 1999, situata në terren nuk kishte degraduar deri në pikën ku do të duhej të imponohej një gjendje e jashtëzakonshme, siç është dëshmuar për shembull nga rrethana që shumica e të paraburgosurve thjeshtë janë thirrur që të paraqiten te policia e UÇK-së për të sqaruar situatën e tyre dhe për të raportuar për aktivitetet e tyre dhe marrëdhëniet e tyre me Serbët.

Së dyti, një *iustitium* (siç njihet në traditën Romake, do të thotë një suspendim i ligjshmërisë republikane, gjatë të cilit *iustitia* nuk ka vepruar dhe që prandaj është implementuar vetëm në rrethana të jashtëzakonshme) mund të pranohet me formalitete procedurale dhe për një periudhë të limituar kohore dhe nuk mund të paraqitet si një dash i kurbanit për ndonjë paligjshmëri. Me siguri se jo për torturime ose vrasje të paraburgosurve pa shqyrtime gjyqësore. Të akuzuarit e njëjtë (dhe disa dëshmitarë: [redacted], 15.7.09, f. 8; [redacted], 9.09.09, f. 19, [redacted] 10.9.09, f. 9) në mënyrë të përsëritur kanë kujtuar vëmendjen e tyre ndaj respektimit të standardeve të theksuara në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe ndaj Konventave të Gjenevës; ata kanë kujtuar që për këtë janë nxjerrë urdhra specifike me shkrim dhe që ushtarët e UÇK-së janë trajnuar për këto çështje. Nëse kjo është e vërtetë, si është e mundur të paraqitet një gjendje e jashtëzakonshme?

Tani është koha që ti kthehemi akuzave individuale, do të thotë pikës 5, pikës 8, pikës 9 dhe pikës 14 të aktakuzës.

Akuza e parë duhet të konsiderohet si ajo çfarë ka mbetur nga pika 5, do të thotë akuza për pjesëmarrje në themelimin dhe përjetësimin e trajtimit çnjerëzor të civilëve Shqiptarë Kosovarë të paraburgosur në qendrën e paraburgimit që gjendej në Llapashticë, duke i strehuar ata të paraburgosur civilë në kushte çnjerëzore, duke i privuar nga higjiena adekuate, ushqimi dhe uji dhe trajtimi i nevojshëm mjekësor, duke iu shkaktuar në këtë mënyrë të paraburgosurve vuajtje të pamasë dhe shkelje të integritetit trupor dhe të shëndetit.

Gjykata Supreme, në analizën e saj të Pikës 5 (faqja 14 e vendimit) nxjerrë përfundimin që trupi gjykues ka kryer një shkelje të dispozitës së nenit 366 para. 1 LPP sepse faktet janë vërtetuar në mënyrë jo të plotë.

Gjykata Supreme ka vërejtur që trupi gjykues i ka vërtetuar disa fakte ("aktgjykimi i shqyrtimit gjyqësor i referohet qendrës së paraburgimit të vendosur në Llapashticë, duke e përshkruar atë si një stallë të vogël përafërsisht tre metra me katër, me vetëm një dritare dhe pa ngrohje dhe ujë. Dyshemeja e saj ka qenë e lagësht dhe të paraburgosurit kanë pasur vetëm dyshekë sfungjeri për fjetje"), por më tej vëren që ka qenë detyrë e trupit gjykues që të krahasojë kushtet shëndetësore dhe të sigurisë të civilëve të paraburgosur

me ato të popullatës në përgjithësi. Vetëm duke e kryer këtë krahasim, standardi i vendosur nga neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës dhe dispozitat përkatëse të Protokollit II, neni 5 (1) (a), përmbushet. Duke e lënë mënjanë krahasimin e përmendur, trupi gjykues i ka vërtetuar faktet në mënyrë jo të plotë.

Përfundimi i arritur nga Gjykata Supreme e vënë këtë trup gjykues në gjendje që të limitojë dukshëm ekzaminimin e fakteve të pikës 5 të aktakuzës. Ajo që kërkohet nga ky trup gjykues është që ai të plotësojë vlerësimin e kërkuar nga Gjykata Supreme, duke e kryer krahasimin e lënë mënjanë nga trupi i mëparshëm gjykues. Për të krahasuar kushtet e të paraburgosurve civil në krahasim me ato të popullatës në përgjithësi, ka qenë e nevojshme që të mblidhen informata mbi kushtet në të cilat ka jetuar popullata Shqiptare gjatë muajve në mes të vjeshtës 1998 dhe pranverës 1999.

Duhet kuptuar që kjo Gjykatë nuk e ka mundësinë tani që të ketë njohuri të drejtpërdrejtë për kushtet në të cilat janë mbajtur të paraburgosurit në Llapashticë: dhjetë vite më vonë, është thjeshtë joreale që të shpresohet që lokalet kanë mbetur të paprekura dhe që ato mund të japin një ide të vërtetë për situatën në të cilën njerëzit të cilëve iu ishte hequr liria kanë jetuar në qendrën e paraburgimit. Trupi gjykues ka përjashtuar vizitimin e vendngjarjes, për të shmangur krijimin e një përshtypjeje të rreme. Është e vërtetë që trupi i mëparshëm gjykues e kishte bërë një vizitë katër vite pasi që kanë ndodhur ngjarjet dhe ashtu mund të ketë formuar një vlerësim mbi kushtet tashmë të modifikuara. Por ky argument në çështje shkon në favor të vendimit për të mos e vizituar përsëri qendrën e paraburgimit, dhe që të përdoret njohuria dhe përshkrimi i fakteve dhe fotografitë që i ka siguruar trupi i mëparshëm gjykues gjatë vizitës së tij (ato janë në dosje dhe janë treguar në Gjykatë gjatë një seance të këtij shqyrtimi gjyqësor). Nëse gjendja faktike ka ndryshuar pas katër viteve, si mund të jetë gjendja faktike pas 10 viteve?

Si përfundim, nuk ekziston asnjë opsion tjetër përveç që të mbështetemi në gjetjet e trupit gjykues të shkallës së parë, tashmë të reflektuara në vendimin e shkallës së parë dhe shkallës së dytë dhe për më tepër të transkriptuara më lart. Gjykata Supreme është mbështetur në to, nuk i ka kontestuar ato dhe i ka marrë si një vlerësim të sinqertë dhe të saktë të kushteve të ndërtesës në të cilën janë mbajtur në paraburgim viktimat. Përshkrimi i ndërtesës dhe i dhomës që është përdorur si qeli paraburgimi, siç është identifikuar gjatë inspektimit okular të 27 Qershorit 2003, nuk është kontestuar nga avokatët e njëjtë mbrojtës dhe prandaj mund të merret nga ky trup gjykues si bazë e vlefshme për vlerësim.

Fjalët që i ka përdorur trupi gjykues në faqen 46 të vendimit të datës 16 Korrik 2003 shprehin, përtej dyshimit, përshtypjen të cilën ia kanë lënë trupit gjykues lokalet në të cilat janë mbajtur të paraburgosurit, së paku natën. Vlen të kujtohet shprehja e përdorur në pjesën: “Edhe në mes të ditës verore kur është mbyllur dera e hyrjes brendësia ka qenë tërësisht e errët...Dhoma ka qenë e lagësht dhe me dimensione që janë vlerësuar të jenë 3 me 4 metra. Sipas mendimit të trupit gjykues, Prokurori Ndërkombëtar ka pasur të drejtë kur ka thënë “Ajo dhomë qartë i mohon fjalët që janë folur në mbrojtje të saj”.

Trupi gjykues ka dëgjuar gjatë rigjykimin një numër dëshmitarësh të cilët kanë folur për kushtet në të cilat janë mbajtur të paraburgosur në Llapashticë dhe të tjerë të cilët kanë

përshkruar kushtet në të cilat ka jetuar popullata Shqiptare gjatë muajve që kanë paraprirë konfliktin dhe gjatë tij. Të gjithë dëshmitarët tashmë ishin dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe shumica (jo të gjithë) kishin dëshmuar përpara gjykatësit hetues. Ata të gjithë kanë konfirmuar deklaratat e tyre të mëparshme, të cilat prandaj janë lexuar për procesverbal, me disa përjashtime.

Në përgjithësi, deklaratat e dhëna në Gjykatë nuk kanë sjellur ndonjë element specifik ose original në pasqyrën e cila tashmë ishte shfaqur nga deklaratat e mëparshme. Qartazi, dëshmitarët dukeshin, dhjetë vite pas ngjarjeve dhe gjashtë vite pas paraqitjes së tyre të mëparshme në gjykatë, të mërziur nga procedura dhe të gatshëm, në përgjithësi, që të përmbyllin në mënyrë më të shpejtë dhe më pak problematike këtë detyrë procedurale, me qëllim që përfundimisht të lënë prapa kujtimet e vështira nga një kohë të cilën shumica e tyre dëshiron që ta harrojë. Pasojë e kësaj ka qenë një shabllon i dëshmimeve të cilave iu mungonte freskia dhe gjallëria, me përgjigje njëfjalëshe, *rutine*; dëshmi pa gjallëri të cilat kanë zgjatur shumë më shkurtë se ato të dhëna gjatë shqyrtimit të mëparshëm gjyqësor ose përpara Gjykatësit Hetues.

Disa shabllone janë shfaqur nga fillimi. Dëshmitarët të cilët kanë qenë viktime përgjithësisht kanë konfirmuar që ushqimi ka qenë i mjaftueshëm, dhe që janë furnizuar me të në mënyrë të rregullt; ata kanë thënë që kanë pasur qasje në ujë dhe që në disa raste ata gjithashtu janë trajtuar kur kanë qenë të sëmurë. Asnjëri nuk është ankuar për kushtet e fjetjes edhe nëse kanë thënë që ka qenë ftohtë. Ata kanë konfirmuar që atyre i është lejuar liria e pakufizuar e lëvizjes në oborrin e shtëpisë ku ndodheshin qelia e paraburgimit dhe shtabi i policisë ushtarake.

Dëshmitarët të cilët kanë ruajtur qendrën e paraburgimit ose kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së kanë dëshmuar që të paraburgosurit janë trajtuar mirë, në kushte të cilat nuk kanë qenë më të këqija se ato të ushtarëve dhe policëve ushtarak të UÇK-së. Ata kanë thënë që e kanë ngrënë ushqimin e njëjtë dhe që ata kanë pasur qasjen e njëjtë në ujë e rrjedhshëm. Ata kanë thënë që i njëjti mjek i ka vizituar edhe pjesëtarët e UÇK-së edhe të paraburgosurit. Edhe kur nuk janë pyetur, kjo kategori e dëshmitarëve ka shtuar që popullata në përgjithësi ka qenë në kushte më të këqija se të paraburgosurit, e detyruar që të ikë nga forcat Serbe që i shkonin pas, pa ushqim dhe strehim, pa kushte minimale për një jetë me dinjitet.

Tani, është e qartë që kushtet për krahasimin e kërkuar nga Gjykata Supreme duhet të identifikohen me kujdes. Në njërin anë kemi kushtet në të cilat kanë qëndruar të paraburgosurit në Llapashticë. Në anën tjetër referenca për "në të njëjtin nivel si popullata vendore civile" nuk mund të limitohet vetëm në atë pjesë të popullatës e cila është dashur që të braktisë shtëpitë e tyre dhe gjërat e tyre personale për të kërkuar mbrojtje nga sulmet e forcave Serbe. Është e ditur dhe e pranuar që pjesë të mëdha të popullatës Shqiptare kanë përjetuar vuajtje të pamasë kur, të dëbuar nga shtëpitë e tyre nën kërcënim me armë apo nga frika prej sulmeve që nuk bëjnë dallim, e kanë gjetur vetën në radhë të gjata të njerëzve të pushpresë që kërkonin strehim në Shqipëri ose në Maqedoni ose që janë fshehur, me të vërtetë të ekspozuar ndaj dimrit të ashpër Ballkanik. Është ditur dhe e pranuar që në ato rrethana ata njerëz nuk kanë pasur ujë, ushqim,

ngrohje të mjaftuar dhe që kanë qenë të ekspozuar ndaj rrezikut të sulmeve të rastit të trupave Serbe. Këto kushte ekstreme kanë qenë pa dyshim shumë, shumë më të këqija se ato që i kanë përjetuar të paraburgosurit në Llapashticë.

Por, siç ka cekur me të drejtë Prokurori gjatë fjalës së tij përfundimtare, kjo nuk ka qenë si rregull gjatë tërë dimrit të 1998 dhe 1999 dhe sidoqoftë nuk mund të merret si parametër për krahasim.

Argumenti bindës i Prokurorit (faqja 6) është që standardi i krahasimit i kërkuar nga dispozita e Protokollit II 5 (1) (a) të Konventës së Gjenevës nuk mund të gjendet në kushtet që i janë imponuar viktimës së një transferimi të dhunshëm apo evakuimi. Të ekspozuar ndaj trajtimit çnjerëzor, ata kthehen në objekte të një veprimi kriminal i cili degradon dhe poshtëron jetën e viktimave dhe prandaj këto kushte nuk mund të konsiderohen si përcaktues i standardit të një minimumi të dinjitetit jetësor për të paraburgosurit në Llapashticë. Sikur ti lejohej forcave në konflikt një mekanizëm i tillë i degradimit reciprok, ai do të përfaqësonte një humbje të trishtueshme të ligjshmërisë ndërkombëtare.

Kësaj duhet ti shtohet gjithashtu që në muajt e fundit të vitit 1998, edhe nëse kanë ndodhur raste të evakuimit të detyrueshëm nga fshatrat, ato ende nuk i kishin marrë përmasat dhe karakteristikat që u bënë më të zakonshme vetëm në pranverën pasuese. Kjo nuk ka për qëllim që të minimizojë vuajtjet e popullatës Shqiptare, të dëbuar *en masse* nga shtëpitë e tyre kur ndërkombëtarizimi i konfliktit provokoi një reagim të hidhur të forcave Serbe që ishin duke u tërhequr mbi popullatën inerte, por kujtimet e shkruara (të cilat janë pjesë e dosjes si "dokumente mbi historikun e ngjarjeve", dosja 10) dhe dëshmitë specifike ([redacted]) konfirmojnë që dimri i vitit 1999 është koha kur zhvendosja e brendshme dhe ndërkombëtare e popullatës arriti proporcione të një ngjarjeje biblike. Nga fjalët e [redacted] (Shef i Shtabit dhe komandant i një brigade, dëshmia e datës 15 Korrik 2009, f. 17) shihet qartë që një rast i evakuimit masiv të rajonit të Podujevës ka ndodhur në fillim të Prillit 1999 ("Më 10 Prill forcat Serbe kanë ndërmarrë një sulm masiv dhe duke falënderuar përqendrimit tonë ne ishim në gjendje që ti detyrojmë që të tërhiqen dhe ti mos lejojmë që ti afrohen civilëve.") dhe që edhe disa ditë më parë kishte ndodhur një sulm mbi popullatën civile ("dëshiroj të shtoj që gjatë fundit të Marsit, me 23 ose 24, gjatë sulmit, popullata është mbështetur në furnizimet e UÇK-së") Dëshmia e [redacted] (9.9.09, f. 4) përcjell të njëjtën linjë: "Në Llapashticë, për sa kohe ishte vendosur Shtabi? [redacted] Nuk e di saktësisht, por mund të them që Shtabi ka qenë në Llapashticë deri në fillim të bombardimeve të NATO-s, përafërsisht". [redacted] 9.9.09., f. 15: "Prishtina ka qenë diçka e veçantë, banorët e Prishtinës janë zhvendosur pak para fillimit të bombardimeve të NATO-s" ... "Prokurori Publik: Jam duke tentuar ti kuptojë kushtet mesatare të jetesës në rajonin e përgjithshëm të Llapit. Cilat janë qytetet më të mëdha në Zonën e Llapit përveç Prishtinës dhe Podujevës? [redacted] Obiliqi dhe Fushë Kosova. Prokurori Publik: A kanë jetuar njerëzit në ato qytete gjatë luftës? [redacted] Natyrisht, në Prishtinë ka pasur njerëz, si edhe në qytete tjera. Unë personalisht nuk kam ardhur në këtë pjesë. Nuk mund të them në relacion me qytetin që kurrë nuk e kam parë, unë vetëm mund të them çfarë kam parë, për këtë mund të ju tregoj".

Nga dëshmitë e disa dëshmitarëve është shfaqur një nocion tjetër: gjatë muajve kur ka funksionuar qendra e paraburgimit në Llapashticë, disa prej bashkëpunëtorëve të dyshuar të Serbëve që pastaj u bënë të paraburgosur thjeshtë janë thirrur që të paraqiten në kampin e paraburgimit, nuk janë arrestuar apo kapur apo zënë në aksion. Ata ishin civilë të cilët u urdhëruan që të lajmërohen personalisht në shtab në Llapashticë. Kjo mënyrë e thirrjes dëshmon që, së paku deri në fund të dimrit, nuk ka mbizotëruar një konfuzion shoqëror i papenguar, dhe kushtet e jetesës edhe pse me siguri ishin degraduar, nuk ishin aq drastike siç ishin përshkruar në fjalët përfundimtare të Avokatëve Mbrojtës.

Kur faktet vendosen në një perspektivë të saktë kohore ajo që shfaqet është se themelimi i qendrës së paraburgimit në Llapashticë i ka paraprirë zhvendosjes së një pjese të madhe të popullatës që ka ndodhur nga fundi i dimrit/fillimi i pranverës 1999. Si pasojë, kushtet në të cilat kanë qëndruar të paraburgosurit dhe kushtet në të cilat ka qëndruar popullata e zhvendosur nuk mund të krahasohen dhe nuk duhet të jenë objekt i një barazimi.

Ne kemi informata të pakta mbi situatën në të cilën gjendej popullata civile, por ajo pak që e dimë mjafton për të nxjerrë përfundimin që kushtet në të cilat ka jetuar popullata në zonën e Llapit nuk kanë qenë aq të dobëta sa kushtet në të cilat kanë qëndruar të paraburgosurit në Llapashticë.

Për fillim, ka pasur liri të mjaftueshme të lëvizjes.

Njerëzit kanë mundur të mendojnë që të lëvizin me një shkallë të lirisë edhe gjatë orëve të mbrëmjes. Dëshmitari 7, [REDAKTUAR] i paraburgosur në Llapashticë për një muaj, duke filluar në fund të Nëntorit 1998, seanca e datës 15.9.09, faqja 36: *"Në çfarë kohe ka qenë dëshmitari në fshatin Barilevë dhe për çfarë arsye ka shkuar atje? [REDAKTUAR]: Ne kemi shkuar atje vetëm sepse kemi dashur, për qejf. Kryetari i Trupit Gjykoes: Në çfarë kohe? [REDAKTUAR] Në mbrëmje, rreth orës 6-7 të mbrëmjes"*.

Edhe nëse jo me bollëk, ngrohja dhe energjia elektrike dhe uji kanë qenë në dispozicion, së paku në Podujevë, gjatë dimrit të 1998/1999 ([REDAKTUAR], 10.9.09, f. 23).

Vendet publike mund të hapeshin për punë. [REDAKTUAR], i cili ka qenë pronarë dhe menaxher i kafenesë/restoranit të tij, ka thënë gjatë seancës së 10.9.09 fq. 3: *"Ai (Rrustem Mustafa) vetëm më ka pyetur se a kanë ardhur ata (policët Serb) dhe a kanë pyetur për ushtrinë. Unë i kam thënë jo, i kam thënë që ky është një lokal biznesi, të gjithë kanë qenë të ftuar që të vijnë për ushqim."*

Këto janë të vetmet rrethana që ishin në dispozicion për kushtet e jetesës së popullatës në rajonin e njëjtë (zonën e Llapit) në dimrin 1998/1999.

Nuk është shumë. Por mjafton për të nxjerrë përfundimin që kushtet në të cilat kanë qëndruar të paraburgosurit me siguri kanë qenë me të këqija dhe që edhe nëse mund të vërtetohet që të paraburgosurit kanë pasur qasje të mjaftueshme në ushqim dhe në ujë (për të pirë dhe për të u larë nganjëherë), megjithatë është e qartë që dhoma në të cilën janë mbajtur natën, apo gjatë ditës, ka qenë nën çfarëdo standardi të pranueshëm. E errët, e lagësht dhe e ftohtë, ka qenë aq e padurueshme sa që të paraburgosurit kanë qëndruar në oborr tërë ditën, edhe gjatë ditëve të dimrit! Sa i përket kësaj, dëshmitë nga ana e

viktimave (), dhe ato nga ana e rojeve (), janë në pajtim.

Kësaj duhet ti shtohet një konsideratë e mëtejme për të karakterizuar më mirë modalitetet e paraburgimit. Këtu i referohemi Pikës 8 të aktakuzës, e cila, siç është konfirmuar nga Gjykata Supreme, ka vërtetuar në mënyrë të pakundërshtueshme që në Llapashticë kanë ndodhur rrahje dhe torturime. Kjo është një e vërtetë gjyqësore që nuk mund të injorohet apo kontestohet nga ky trup gjykues. Edhe nëse jo të gjithë të paraburgosurit i janë nënshtruar dhunës gjatë paraburgimit të tyre, është krejtësisht abstrakte që ata nuk kanë ditur se çfarë përjetonin të bashkë-paraburgosurit e tyre. Kjo duhet ti ketë kontribuar, në mesin e të paraburgosurve, një atmosfere të shtypjes dhe frikës se do ti nënshtrohen dhunës, siç pretendohet në Pikën 5 të aktakuzës. Kjo ishte një gjendje e cila, në vetvete, e ka ulur standardin e jetesës nën një nivel të dinjitetshëm

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, trupi gjykues nxjerrë përfundimin që kushtet e paraburgimit në Llapashticë kanë qenë shumë më të ulëta se kushtet e jetesës së popullatës në Podujevë dhe në rajonin përreth saj.

Prandaj, përgjegjësia e të akuzuarve konfirmohet, sa i përket roleve përkatëse që të akuzuarit i kanë pasur në atë kohë. Si personi përgjegjës për policinë ushtarake, i cili ka pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë për qendrën e paraburgimit dhe lokalet përreth, Nazif Mehmeti është dashur që të i raportojë eprorit të tij (Rrustem Mustafa) që lokalet ishin të mbushura plot e përplot dhe që atyre i mungonin kushtet themelore për ti mbajtur njerëzit të kufizuar. Latif Gashi, një njeri i veprave i cili ishte ngarkuar me detyrën që të mbledh informata, ka pasur qasje të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në këtë qeli dhe i ka vizituar dhe marrë në pyetje dhe i ka rrahur të paraburgosurit, duke i raportuar drejtpërsëdrejti eprorit të tij, Rrustem Mustafa. Ky i fundit i ka toleruar të gjitha këto. Ai e ka ditur situatën por ka menduar se ishte e pranueshme që njerëzit që dyshoheshin se ishin bashkëpunëtorë të Serbëve ose telashe për popullatën të vuajnë trajtimin i cili i imponohej atyre.

Shprehja “ndërmarrje e përbashkët kriminale” nuk nënkupton një organizatë kriminale siç është mafia ose triadet Kineze, të cilat janë krijuar për tu marrë me krime dhe që gjejnë në vet organizatën një burim të fuqisë nëpërmes shtypjes dhe kërcënimit. Shprehja “ndërmarrja e përbashkët kriminale” më saktë tregon, në rrethana të caktuara, një dituri dhe dashje të përbashkët, apo pranim, të situatës; një gjendje psikologjike që reciprokisht ushqen dhe vërteton në mesin e atyre të cilët e ndajnë dhe përtej tyre, në komunitetin e ushtarëve, një tolerancë ndaj paligjshmërisë dhe një mungesë të disiplinës dhe përgjegjësisë.

Ka pak për tu thënë për Pikën 8 të aktakuzës. Përgjegjësia e të tre të akuzuarve është pohuar dhe konfirmuar gjatë fazës së kaluar të shqyrtimit gjyqësor dhe ky trup gjykues e vëren këtë.

Detyra e vetme e këtij trupi gjykues lidhur me Piken 8 të aktakuzës është caktimi i dënimit, me të cilin do të merremi në një fazë të mëvonshme të vendimit.

Pika e tretë që duhet të konsiderohet është pika 9 e aktakuzës.

Prokurori e ka tërhequr këtë akuzë në fillim të fjalës së tij përfundimtare.

Trupi gjykues vetëm mund të konstatojë këtë dhe të refuzojë pikën e aktakuzës, pas leximit të nenit 349 p.3 të Ligjit të Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Pika e fundit që do të konsiderohet është pika numër 14 e aktakuzës, ku përshkruhet keqtrajtimi, abuzimi fizik dhe torturimi i [REDAKTUAR] nga ana e Latif Gashit, gjatë dy muajve të verës në vitin 1998 përderisa rojtari Serb i pyllit ka qenë i paraburgosur në qendrat e paraburgimit në Bare dhe Bajgorë.

Gjatë analizimit të kësaj pike të aktakuzës, Gjykata Supreme, në vendimin e saj të datës 21 Korrik 2005 kryesisht përqendrohet (pjesa e dytë e f. 19) në një ngjarje specifike që i ka ndodhur [REDAKTUAR] gjatë paraburgimit të tij, e cila ka qenë objekt i një analize të përpiktë nga ana e trupit gjykues të shkallës së parë. Gjykata Supreme, mbi këtë aspekt, i tregon përfundimet e trupit gjykues dhe citon 7 rreshta nga vendimi i shkallës së parë, në fund të cilëve thuhet që asnjë përfundim i pafavorshëm për të pandehurin Gashi nuk mund të bazohet "mbi këtë pjesë të dëshmisë së [REDAKTUAR]". Gjykata Supreme pastaj vërteton që në vendimin e trupit gjykues nuk ka asnjë gjetje "që Latif Gashi ka kryer apo urdhëruar rrahjen dhe torturimin e [REDAKTUAR] në Bajgorë" dhe që "gjetjet në dispozitivin e aktgjykimit të trupit gjykues se akuza nga Pika 14 është vërtetuar janë kontradiktore dhe në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit".

Përfundimet e Gjykatës Supreme do të pranohen nga kjo Gjykatë e shkallës më të ulët, edhe pse duhet potencuar që trupi gjykues i shkallës së parë ia ka dedikuar faqet 43 dhe 44 të vendimit të tij gjetjeve që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e Latif Gashit për rrahjen e [REDAKTUAR] dhe kualifikimit të saj ligjor (si krim lufte).

Kjo Pika e fundit (14) e aktakuzës është më e kundërshtuara, nga ato që kanë mbijetuar fazën e parë dhe të dytë të shqyrtimit gjyqësor; gjatë seancës gjyqësore, dëshmia e dëshmitarit ka shkaktuar një reagim të ashpër të avokatëve.

Dikush do të thoshte, cila është arsyeja për të u brengosur veçanërisht për pikën 14 të aktakuzës, e cila e vërtetuar ose e pavërtetuar, nuk do të ndryshonte në thelb peshën e përgjegjësisë tashmë të konstatuar sa i përket të akuzuarit Latif Gashi? Pas vërtetimit të

përgjegjësisë së të tre të akuzuarve sa i përket pikës 8 të aktakuzës, ku akuza i referohet rrahjeve dhe torturimeve që i janë shkaktuar një numri të paraburgosurve, si një lloj rutine, në të vërtetë çfarë ndryshimi mund të bëj edhe një viktimë tjetër?

Arsyeja për reagimin e ashpër është se [redacted] përfaqëson, në sytë e të akuzuarve (gjithashtu të atyre që më nuk janë të përfshirë në pikën e aktakuzës) dhe të avokatëve të tyre mbrojtës, një provë për trillimin e akuzave dhe të gjykimit. Duke qenë Serb, ai do të mund të ishte përdorur nga shërbimet sekrete të Serbisë për të diskredituar dhe fëlliqur imazhin e disa prej pjesëmarrësve më trima të komunitetit Shqiptar në Kosovë në luftën çlirimtare. Nëpërmjet dokumenteve të sajara dhe dëshmimeve të blera, shërbimet sekrete të sundimitarit të mëparshëm do të kishin arritur që të ndikojnë në hetimet, ndjekjen penale dhe, në një mënyrë, gjithashtu në shqyrtimin gjyqësor deri tani.

Ky argument nuk është real dhe nuk është i bazuar mbi deklaratatë të cilat mund të vërtetohen. Është vetëm një pretendim i cili kurrë nuk ka shkuar përtej fazës së paraqitjes së tij. Është interesante që ai është parashtruar në mënyrë kaustike dhe me vendosmëri vetëm sa i përket njërit prej shumë dëshmitarëve të shqyrtimit gjyqësor. E të tjerët? Të gjithë ata që janë rrahur dhe torturuar në Llapashticë, siç është vërtetuar sa i përket pikës 8 të aktakuzës, të cilët janë konsideruar të besueshëm nga Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë? Po të absorbohej pika 14 në pikën 8 të aktakuzës (sjelljet identike kriminalizohen në të dy pikat e aktakuzës) çfarë peshe do të kishte një argument i tillë? Kur ekzistojnë disa dëshmitarë që kallëzojnë për torturimet, cila është arsyeja për të thënë që vetëm një prej tyre është i anshëm ose përfaqësues i shërbimeve sekrete të Serbisë?

Ajo që sapo u tha na sjellë te një rrethanë tjetër. Pika 14 e aktakuzës është një akuzë autonome. Megjithatë, sjelljet (rrahjet dhe torturimet) janë identike me ato që janë përshkruar në Pikën 8, ndryshojnë vetëm lokacionet, periudha kohore dhe numri i viktimave. Trupi gjykues ka kuptuar që vetëm arsyet praktike në formulimin e aktakuzës e kanë shtyrë prokurorin që të shkruaj edhe një pikë (pikën 14). Por historia e brutalitetit e përshkruar në aktakuzë është unike; një histori që ka filluar në Gusht 1998 dhe ka vazhduar deri në fundin e pranverës pasuese.

Pasi që është vërtetuar që të paraburgosurit në Llapashticë janë torturuar dhe rrahur, pse duhet trupi gjykues të heq dorë nga mendimi që torturimet dhe rrahjet gjithashtu kanë ndodhur edhe në vende tjera, do të thotë në Bare/Bajgorë? Nëse ka ekzistuar një shabllon i sjelljeve i prirur për dhunë ndaj të paraburgosurve, atëherë nuk ka asnjë arsye për të menduar që kjo ka qenë karakteristike dhe e kufizuar vetëm sa i përket Llapashticës dhe që tashmë nuk është provuar në Bare dhe Bajgorë.

[redacted] ka dhënë një dëshmi e cila dukej e sigurtë dhe e vërtetë. Është e vërtetë që dëshmia e tij përmbajti disa kontradikta dhe konfuzione të vogla dhe është e vërtetë që ai nuk mundi të identifikojë Latif Gashin në Gjykatë.⁴ Por kjo nuk cenon besueshmërinë e

⁴ Duhet konstatuar, edhe pse nuk është shënuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, që në momentin kur është bërë kërkesa për identifikim dhe gjatë tij Latif Gashi i ka kryqëzuar duart mbi gjoks dhe e ka vendosur dorën dhe gishtin e dytë te fytyra, për të mbuluar nishanin që e ka në fytyrë. Këtë e ka bërë me

tij. Në të kundërtën, e bën edhe më të largët mundësinë e dëshmisë së rreme dhe të trillimit të dëshmisë së tij nga ana e shërbimit sekrete të Serbisë. Po ta kishin stërvitur dëshmitarin shërbimi sekrete, ai me siguri do ta kishte identifikuar Latif Gashin në Gjykatë.

█ gjatë dëshmisë së tij nuk dukej si njeri të cilin e përdorin të tjerët e as si dikush i cili por i shërben apo po e kënaq dikë tjetër. Ideja që një njeri aq i thjeshtë mund të përdoret nga diçka që është përshkruar si shërbim i kualifikuar sekret, është naive. Mënyra në të cilën ai ka folur dhe mënyra si është prezantuar (duke përfshirë edhe mbështetjen, gjatë dëshmisë, në shënimet që i ka bërë në copa të vjetra letre – shih procesverbalin e seancës së 15.9.09, f. 17) është larg nga pasqyrimi i tij si një ekzekutor dinak, siç tentuan ta pasqyrojnë avokatët mbrojtës.

Sipas mendimit të trupit gjykues, dëshmia e tij ishte e besueshme dhe mjaft e qartë, duke marrë parasysh se kanë kaluar 10 vite. Fjalimi i tij ishte përqendruar rreth disa çështjeve për të cilat kujtesa e tij ishte ende e qartë (momenti i arrestimit, mënyrat e marrjes në pyetje, kërkesat e ngulëta për informata për █, lëvizja nga Bare për në Bajgorë, rrethanat e identifikimit të Latif Gashit gjatë marrjes në pyetje përpara gjykatësit hetues). Deklarata e tij kryesisht është përputhur me deklaratat që i ka dhënë në 2002 përpara gjykatësit hetues dhe 2003 përpara trupit gjykues, në një shkallë e cila e bën shumë të vështirë që të mendohet se dëshmitari do të mund të kujtonte pas kalimit të shumë viteve ato që i ka thënë më parë, sikur ato rrethana të ishin të shpikura dhe të përsëritura përmendësh, e jo të përjetuara drejtpërsëdrejti.

Gjatë marrjes në pyetje nga ana e Z. Sylja dhe Z. Tmava, dhe me disa pyetje përfundimtare që i ka pyetur Z. Balaj, dëshmitari nuk ka shfaqur kurrfarë pasigurie ose dobësie thelbësore dhe ka qenë në gjendje që të përgjigjet lidhur me çështjen dhe atë menjëherë.

Përfundimisht, mbi çështjen e identifikimit të akuzuarit, ekzistojnë rrethana të cilat prokurori i ka theksuar me shumë efikasitet në fjalën e tij përfundimtare. Z. Dean ia ka tërhequr vëmendjen trupit gjykues mbi vërtetimin që mund të gjendet në dosje sa i përket shënimeve personale dhe profesionale të akuzuarit, të cilave i është referuar █ Fshati i prejardhjes, profesioni, historia e tij si mësues apo drejtor shkolle, emigrimi për në Gjermani, të gjitha janë detaje që në një mënyrë apo tjetrën mund të konfirmohen nga dosja (siç tregoi Prokurori, në deklaratat e Latif Gashit dhe të një dëshmitari – dëshmitarit 4).

Në fund, trupi gjykues nuk ka asnjë dyshim sa i përket përgjegjësisë së Latif Gashit në rrahjet e përsëritura, që përbëjnë torturim, për të detyruar █ që të jep një deklaratë vet-akuzuese. Latif Gashi jo vetëm se ka qenë i pranishëm dhe e ka drejtuar marrjen në pyetje, ai ka qenë prezent në secilën fazë relevante të përvojës së rëndë të cilën e ka përjetuar viktima █ nga ditët pas arrestimit deri në momentin e fundit kur ai është liruar. Ai gjithashtu ka luajtur një rol për të cilin e kishte edhe titullin, përgjegjës për inteligjencë. Ai e ka kryer punën e tij me përkushtim dhe zotim personal,

qëllim, dhe këtë e ka kuptuar trupi gjykues, edhe pse këtë e ka mbuluar me një qëndrim të reflektimit dhe përqendrimit.

së paku derisa filloi të jetë gjithmonë e më shumë i angazhuar në operacionet ushtarake. Është e rëndësishme që në dëshminë e [REDAKTUAR], prania e tij lidhet me rrahjet: (seanca e 15.9.09, f. 17) Kryetari i Trupit Gjykses: Në Bajgorë, sa gjatë ke qëndruar? [REDAKTUAR]: Më duket se në Bajgorë kemi qëndruar deri më 15 apo 17 Shtator. Kryetari i Trupit Gjykses: A të kanë rrahur përsëri në Bajgorë? M.S.: Jo, nuk më kanë rrahur.

....

F.18: "Kryetari i Trupit Gjykses: A ka qenë Latif Gashi vazhdimisht i pranishëm në Bajgorë dhe në Bare? Apo ka ardhur kohë pas kohe? [REDAKTUAR]: Në Bare ka qenë i pranishëm tërë kohën, përderisa në Bajgorë ka ardhur vetëm disa herë."

Eksperiencia gjyqësore na mëson që sa më shumë që të zgjatë procedura, aq më e madhe është tendenca për të pasur prirje më të butë ndaj të akuzuarve. Kjo është e natyrshme. 11 vite pas ngjarjeve, zëri i dëshmitarit dobësohet, dokumentet duken gjithmonë e më shumë si copa letre të mira për një libër historie më tepër se si prova dhe në përgjithësi, zbehet mundësia për të gjetur konfirmimin e akuzave në deklaratat dhe dokumente. Pjesërisht, kjo ka ndodhur edhe në këtë shqyrtim gjyqësor, ashtu që aktakuza fillestare, gjatë veprimeve gjyqësore është zvogëluar në mënyrë progresive deri në një numër të limituar të pikave të aktakuzës, dhe prokurori është detyruar të heq dorë nga njëra prej akuzave të mbetura. Megjithatë, do të ishte gabim që të krijohet përshtypja që ajo që ka ndodhur në Llapashticë dhe në vendet tjera ku personat që janë pretenduar të jenë bashkëpunëtorë të Serbëve janë kufizuar, është përbërë prej vetëm disa shuplaka duarve dhe pak keqtrajtimi.

Ka ndodhur më shumë, shumë më shumë. Ka ekzistuar një sistem i cili ka lejuar jo vetëm torturimin por gjithashtu edhe heqjen qafe të njerëzve të cilët, për arsye të ndryshme, sipas mendimit të gardianëve të tyre, nuk është dashur të kthehen në shtëpi. Fakti që pika 11 e aktakuzës ka rënë do të thotë vetëm që nuk është vërtetuar që të akuzuarit kanë qenë përgjegjës për vrasje. Nuk do të thotë se individët si [REDAKTUAR] nuk janë vrarë apo që ata kanë vdekur në mënyrë të natyrshme.

Në këtë mjedis, kur torturimi dhe vrasja e bashkëpunëtorëve të dyshuar është pranuar (ndoshta, për të eliminuar dëshmitarët e brutaliteteve), është thjeshtë e palogjikshme dhe e paqëndrueshme që sistemi i marrjes në pyetje ka qenë rreptësisht i ndaluar sepse nuk ka qenë i dobishëm dhe për të respektuar konventat e Gjenevës (të cilat, në fund, nuk ndalojnë marrjet në pyetje. Fakti që në mbrojtjen e tyre të akuzuarit me këmbëngulje kanë hedhur poshtë mundësinë që në të vërtetë, të paraburgosurit janë marrë në pyetje, nuk është shenjë e sofistikimit të madh. Këmbëngulësia të cilën e shfaqën të akuzuarit (dhe dëshmitarët, të gjithë pjesëtarë të UÇK-së të niveleve të ndryshme, të cilët e përsëritën këtë version si një parullë) mbi këtë çështje nuk peshon në favor të besueshmërisë së të akuzuarve në përgjithësi dhe diskrediton aftësinë e tyre që të deklarohen mbi çështjen në mënyrë të sinqertë.

Para se të kalojmë te dënimi, duhet zgjidhur një çështje të fundit procedurale.

Në princip, pozita e të ndjerit Naim Kadriu ende është zyrtarisht e pazgjidhur. Pasi që dihet që Z. Kadriu ka vdekur, trupi gjykues, në bazë të propozimit që e ka bërë vet, ka siguruar një kopje të certifikatës së vdekjes së Naim Kadriut nga Komuna e Podujevës.

Pasi që është kryer ky formalitet, dhe pasi që ajo që është ditur në mënyrë jo zyrtare është konfirmuar, trupi gjykues zyrtarisht konstaton që ai ka vdekur dhe si pasojë, sipas Nenit 143 LPP pezullon procedurën penale kundër të akuzuarit të përmendur.

DËNIMI

Kjo pjesë e vendimit do të jetë e shkurtër, duke marrë parasysh që ky trup gjykues kryesisht aprovon vlerësimin që mbi këtë çështje e ka shprehur trupi gjykues në vendimin e tij të 16 Korrikut 2003.

Ky trup gjykues është i mendimit që mënyra në të cilën janë përshkruar të akuzuarit në atë dokument gjyqësor reflekton një kuptim të drejtë të lidhjes psikologjike në mes tyre, të motivimeve të tyre dhe të vlerave të tyre personale gjatë konfliktit. I pastruar nga vlerësimet që kanë të bëjnë me pikat e aktakuzës që nuk i kanë mbijetuar fazat e ndryshme të shqyrtimit gjyqësor, vlerësimi i bërë aty është ende bazë e vlefshme për politikën tonë sa i përket dënimit.

Duke filluar nga Nazif Mehmeti, është e qartë që edhe nëse ai bartë përgjegjësi për keqtrajtimet në Llapashticë, për shkak të funksionit të tij si shef i policisë ushtarake në atë rajon, këtu mund të përsëritet që “përgjegjësia e tij është zvogëluar...pasi që...ai nuk e ka nxitur regjimin por e ka mbështetur funksionimin e tij më mënyrë aktive. Si rrethanë lehtësuese, është e qartë që ...ai ka qenë...i ndikuar nga pesha e ngjarjeve në të cilat kishte marrë pjesë”.

Duhet shtuar edhe që ai dukej, gjatë seancave gjyqësore dhe pas shqyrtimit të procesverbaleve të tërë shqyrtimit gjyqësor, si një pjesëmarrës me rëndësi të vogël në ngjarje, një ekzekutor i nënshtruar i projektit të të tjerëve, deri në pikën ku meritoi një vërejtje atësore nga Rustem Mustafa, i cili gjatë marrjes fillestare në pyetje e ka përshkruar karakterin e Mehmetit si “shumë i sjellshëm” (9.07.09, f. 24).

Sa i përket Latif Gashit, ky trup gjykues ka konfirmuar bindjen që ai ka qenë në qendër të një sistemi i cili ka lejuar marrjen në pyetje, rrahjet dhe torturimet që nga ditët e hershme në Bare e deri në fund të mbylljes së kampit në Llapashticë. Ai është njeri i aksionit, të cilit i është dhënë një punë (shef i inteligjencës) e cila e ka lejuar që të shprehet me brutalitet dhe cinizëm. Përfshirja e drejtpërdrejtë dhe e vërtetuar e tij në rrahjet dhe

përgjegjësia e tij personale për tri pika të aktakuzës justifikon dënimin më të rëndë që është shpallur kundër tij.

Sa i përket Rrustem Mustafës, trupi gjykues nxjerr përfundimin që përgjegjësia e tij rrjedh nga pozita e tij e autoritetit dhe nga fakti që ai i ka toleruar ngjarjet, edhe nëse nuk i ka urdhëruar drejtpërsëdrejti, në pozitën e tij si drejtues i hierarkisë së UÇK-së në zonën e Llapit. Ai, me besnikëri, asnjëherë nuk ka tentuar që të fajësojë vartësit e tij për ndonjëherë nga ngjarjet që janë konstatuar.

Pasi që ka vërtetuar përgjegjësitë në kushtet e cekura, trupi gjykues konsideron që edhe pse të gjitha ngjarjet janë pjesë e një akuze unike për krime lufte, megjithatë duhet që të vërtetohet përgjegjësia individuale në lidhje me secilën ngjarje ndaras, për të matur më mirë kohëzgjatjen e dënimit dhe me qëllim të shmangies së rrezikut që zhvillimet e mëtejme në shqyrtimin gjyqësor, në një fazë të mëvonshme, do të duhet të ballafaqohen përsëri me problemet e shkaktuara nga opsioni i dënimit të vetëm.

Duke marrë si më të rëndat sjelljet e përshkruara në Pikën 8 (duke i konsideruar rrahjet dhe torturimet e përsëritura si më të rënda se paraburgimin në kushte çnjerëzore, Rrustem Mustafa dënohet me 4 vite burgim, Nazif Mehmeti me 3 vite burgim dhe Latif Gashi me 5 vite burgim. Sa i përket Pikës 5, 2 vjet i shtohen dënimit të Rrustem Mustafës, 1 vit dhe gjashtë muaj dënimit të Nazif Mehmetit dhe 2 vite dënimit të Latif Gashit. Përfundimisht, sa i përket Pikës 14, edhe Latif Gashi dënohet me edhe 2 vjet tjera burgim, të cilat duhet ti shtohen atyre të mëparshmeve që shpallen kundër të akuzuarit. Totale rezultatuese (6, 4.5 dhe 9 vite, respektivisht) janë objekt i aplikimit të rrethanës zvogëluese që aplikohet ndaj të gjithë të akuzuarve.

Rrethana zvogëluese përbëhet nga kohëzgjatja jashtëzakonisht e gjatë e shqyrtimit gjyqësor. Nga 21 Korriku 2005 deri në fillim të rigjyqimit (7.07.09) dosjet kanë qëndruar diku pa u marrë asnjë veprim. Të akuzuarit, të liruar nga Gjykata Supreme e Kosovës por nën masa që kufizonin lirinë e tyre të lëvizjes, është dashur të presin katër vite për vlerësimin e përgjegjësisë së tyre dhe mundësinë që të deklarohen mbi çështjen. Kjo është një periudhë jashtëzakonisht e gjatë, gjatë të cilës, siç dëshmohet nga procesverbalet e mbledhjeve paragjyqësore dhe memorandumeve të brendshme që janë në dosjen 16, janë marrë vetëm iniciativa jopërfundimtare nëse jo bishtnuese për të rifilluar shqyrtimin gjyqësor, nga ana e Divizionit Ndërkombëtar të Mbështetjes Gjyqësore të UNMIK-ut.

Ulja e sanksionit prandaj aprovohet në maksimum të spektrit, dhe i sjell kohëzgjatjet e burgimit siç janë vërtetuar në dispozitiv.

KËRKESË PASURORE JURIDIKE

Vuajtjet që i ka përjetuar [REDAKTUAR] gjatë keqtrajtimit të cilit i është nënshtruar nga ana e Latif Gashit janë një dëm i cili duhet të kompensohet, pasi që viktima e krimit e

ka kërkuar këtë qartë kur është dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pas kalimit të shumë viteve dhe në mungesë të një vlerësimi specifik nga ana e një dëshmitari ekspert, një vlerësim i drejtë është ende i mundshëm. Trupi gjykues pajtohet që pagesa prej 5.000,00 Euro mund të paraqet një kompensim të konsiderueshëm për rrahjet dhe keqtrajtimet e përsëritura të cilave i është nënshtuar [REDACTED]

SHPENZIMET E PROCEDURËS

Të akuzuarit do të kompensojnë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 98 Paragrafi 1 dhe 2 të LPP, me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit. Trupi gjykues do të lëshojë një aktvendim ndaras mbi shumën e shpenzimeve pasi që të sigurohen shënimet e tilla, në pajtim me nenin 96 të LPP.

Kryetari i Trupit Gjykues
Francesco Florit

Nëpunësi i Gjykatës
Francesco Caruso

